



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 18 regjistër (JR)
Datë 02.10.2018

Nr. 5 i vendimit
Datë 18.02.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Ardian Hajdari	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Luan Daci	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 18.02.2019, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar John Leonardo, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 18/2018 (JR), datë 02.10.2018, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 62 e vijues, neni 66, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) me vendimin nr. 35, datë 12.07.2018, ka vendosur:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Cama, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

2. Vendimi nr. 35, datë 12.07.2018, është marrë nga Komisioni, bazuar në kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit Adriatik Cama (në vijim subjekti i rivlerësimit), pasi ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016.

3. Komisioni, pasi arriti në konkluzionin që provat kishin nivelin e provueshmërisë, përfundoi hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin e kriterëve të vlerësimit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës. Në vendimin nr. 35, datë 12.07.2018, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në këto konkluzione:

- referuar deklaratës së pasurisë së vitit 2003 dhe deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit;

- subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2003;

- subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e depozitës bankare në maj të vitit 2008, në emër të bashkëshortes së tij;

- nga verifikimi i deklaratës së pasurisë së vitit 2009 konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendjen e likuiditeteve në bankën “Credins”, në vlerën prej 1039 eurosh;

- subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, nuk kanë deklaruar gjendjet e llogarive bankare në fund të viteve përkatëse;

-subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve për vitin 2009;

-subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve për vitin 2010;

-ka bërë deklaram të rremë pranë këtij Komisioni lidhur me financimin e llogarive bankare të tij, si dhe nuk ka deklaruar të ardhurat e kredituara në llogaritë e tij dhe të bashkëshortes së tij ndër vite, si dhe burimin e krijimit të tyre.

Në përfundim të vlerësimit të kontrollit të figurës për këtë subjekt, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

II. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, të Komisionit ka bërë ankim subjekti i rivlerësimit në mbështetje të nenit 62 e vijues e nenit 66, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar prishjen e vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë, bazuar në këto shkaqe:

4.1 Vendimi i Komisionit nr. 35, datë 12.07.2018, është marrë në moszbatim të parimeve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, si gjatë procesit të hetimit administrativ, ashtu edhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore. Për këtë arsye, ky vendim rezulton të jetë me një mungesë të thellë analize juridike të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë për këtë çështje, me trajtim të njëanshëm të provave (shih pikat 12, 13 të vendimit), me shprehje kontradiktore dhe të paqarta në paragrafë të ndryshëm, me fakte të rreme e të pavërteta (shih paragrafin 29.5, faqja 36 e vendimit), si dhe në kundërshtim me parimin e arsytimit të vendimeve gjyqësore.

4.2 Keqlllogaritjet e Komisionit mbi pambulueshmërinë e pasurisë me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, nuk mund të përbëjnë në asnjë standard vlerësimi, dyfishin e të ardhurave të tyre familjare në 25 vite punë.

4.3 Nga një lexim e interpretim logjik i Aneksit të Kushtetutës dhe vetë ligjit nr. 84/2016 del qartë që subjekti i rivlerësimit mban përgjegjësi, vetëm nëse në deklaratën e dorëzuar për efekt të procesit të rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë, ka fshehur pasuri apo ka pasaktësi të qëllimshme

në lidhje me pasuritë dhe burimet e krijimit të tyre. Nuk është aspak kushtetuese dhe ligjore që subjekti të mbajë përgjegjësi për deklarata të dhëna para 15 vjetësh, sa kohë që ato deklarata kanë qenë njëherë objekt kontrolli nga ILDKPKI-ja, që është institucioni i ngarkuar me ligj. Vlera e vetme e deklarimeve të bëra ndër vite nga subjekti i rivlerësimit është që të mund të përdoren si prova, në funksion të verifikimit dhe kontrollit të deklarimeve të bëra për efekt të rivlerësimit.

4.4 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, subjekti ka bërë deklaram të saktë në lidhje me vlerën e apartamentit 76,73 m² në rrugën “{***}”, pasi ai është çmimi i vërtetë që ka paguar subjekti te shoqëria ndërtuese. Komisioni mban qëndrim kontradiktor, duke arsyetuar fillimisht se subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë të dokumentimit të çmimit të pretenduar prej 3,4 milionë lekësh për apartamentin e më pas duke rrëzuar pa të drejtë kërkesën e subjektit për të marrë dëshminë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, për më tepër që deklaratën noteriale të shtetasit R. Z., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, e ka konsideruar fiktive. Për këtë arsye, subjekti kërkon që kjo dëshmi të merret nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

4.5 Në arsyetimin e Komisionit renditen pa konkludim apo interpretim konkret dualizimi i firmave ndërtuese apo ndryshimet e emërtimeve të adresës së apartamentit 76,73 m², ndërkohë që subjekti ka shpjeguar saktë dhe ka provuar se ky apartament është ndërtuar vetëm nga shoqëria “{***}” ShPK, kurse pasqyrimi i adresave të ndryshme në deklaratat periodike të pasurisë ka ndodhur vetëm për të deklaruar adresën më të saktë të mundshme.

4.6 Në llogaritjen e të ardhurave për periudhën kohore para vitit 1997, Komisioni ka pranuar pamundësinë objektive të provueshmërisë nga subjekti të të ardhurave nga paga, por pa të drejtë nuk ka marrë parasysh shpërblime të tjera të ligjshme të punës së prokurorit, si: shpërblimi i orëve jashtë orarit, i gatishmërive e të tjera kompensime financiare të ligjshme. Gjithashtu, në shpenzimet e jetesës deri në fund të vitit 2003, Komisioni nuk ka zbritur akomodimin falas të subjektit në institucione shtetërore apo te të afërmit, si dhe ndihmesën në produkte ushqimore të familjarëve të tij.

4.7 Konkluzioni i Komisionit, se subjekti ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë ambient (ish-parkim, garazh) dyqan, është rrjedhojë e një arsyeimi të gabuar dhe jologjik mbi provat e marra gjatë shqyrtimit administrativ, pasi gjendjen *cash* të deklaruar nga subjekti në vitet 2003 e 2004, duke qenë se nuk është deklaruar në vitin 2005 deri në vitin 2008, Komisioni e ka deduktuar si të përdorur ose të harxhuar përgjatë vitit 2005. Në vitin 2005 deri në vitin 2009, kur është blerë pasuria dyqan, të ardhurat nga pagat kanë qenë më se të mjaftueshme për të përbaluar shpenzimet e jetesës, pa cenuar kursimet familjare.

4.8 Dyshimi i shprehur në vendim, në lidhje me vlerën reale të deklarimit të blerjes apo të shitjes së autoveturës “Mercedes Benz” nga subjekti, është totalisht i pambështetur në provat e marra në shqyrtim e nuk duhej të ishte ngritur si i tillë, pasi vetë përmbajtja e kontratës së shitjes së autoveturës dhe vlera e tregut të shitblerjes së automjeteve të përdorura në vitin 2009, përcaktojnë qartësisht vlerën e shitjes.

4.9 Konkluzioni i Komisionit se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e automjetit të markës “Volkswagen” në qershor 2010 është i gabuar, pasi subjekti ka pasur gjendjen *cash* prej 1 milion lekësh, të prezumuar pa të drejtë nga Komisioni si të shpenzuar deri në vitin 2005, për shkak se nuk është deklaruar si gjendje *cash* nga viti 2005 deri në vitin 2009.

4.10 Konkluzioni i Komisionit se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e depozitës bankare në vitin 2008, në emër të bashkëshortes së tij, është i gabuar, pasi subjekti nga gjendja *cash* prej 1 milion lekësh, të prezumuar pa të drejtë nga Komisioni si të shpenzuar deri në vitin 2005, një pjesë të tyre në shumën 4.000 euro i ka vendosur në depozitë të përkohshme në vitin 2008, e domosdoshme kjo për marrjen e një vize “Shengen”.

4.11 Vendimi i Komisionit nr. 35, datë 12.07.2018, në lidhje me kontrollin e figurës është i njëanshëm, pasi refuzimi për t’u pyetur si dëshmitar cilido subjekt i aluduar si dhënës i një mite ndaj subjektit të rivlerësimit, e ka zhveshur atë nga mbrojtja efektive, në kundërshtim të plotë me parimet e procesit të rregullt ligjor të shprehur edhe në vendimet e GjEDNj-së.

4.12 Akti i vetëm i renditur si provë, në vlerësimin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, daton në vitin 2005 dhe, edhe vetëm për këtë fakt, ky akt nuk duhet të përbënte relevancë shqyrtimi.

4.13 Komisioni nuk ka kryer aspak hetim dhe aq më tepër një hetim të plotë e të gjithanshëm, për sa i takon vlerësimit të figurës së subjektit të rivlerësimit, duke marrë të mirëqenë një informacion të pavërtetë të DSIK-së. Atribuimi i një fakti korruptiv, pa përcaktime konkrete të personit korruptues, përbën shkelje të të drejtave themelore e atyre të posaçme për subjektin, në këtë proces.

4.14 Në konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm për detyrën, nuk është zbatuar asnjë standard i nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, pasi atij nuk i atribuohet asnjë kontakt i çfarëdolloji me subjekte që janë përfshirë apo dyshohen si pjesëtarë të strukturave të organizuara kriminale, madje DSIK-ja përcakton që formulari i plotësuar nga subjekti është tërësisht i saktë dhe në përputhje me ligjin, ndërkohë që në konkluzion, Komisioni mbërrin në të kundërtën përkatëse.

III. Rrethanat e çështjes

5. Subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
6. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ka raportuar se:
 - a) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;

- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

7. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport, në përfundim të të cilit ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Adriatik Cama.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

8. Në shqyrtim dhe vlerësim të procedurës administrative të ndjekur gjatë procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale që ka paraqitur subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji) arsyeton si më poshtë.
9. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit nr. 35, datë 12.07.2018, është marrë në moszbatim të parimeve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, si gjatë procesit të hetimit administrativ, ashtu edhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore e, për këtë arsye, ky vendim rezulton të jetë me një mungesë të thellë analize juridike të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë për këtë çështje, me trajtim të njëanshëm të provave (shih pikat 12, 13 të vendimit), me shprehje kontradiktore dhe të paqarta në paragrafë të ndryshëm, me fakte të rreme e të pavërteta (shih paragrafin 29.5, faqja 36 e vendimit), si dhe në kundërshtim me parimin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore.* Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimi i subjektit në lidhje me moszbatimin e parimeve të Kodit të Procedurës Civile gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, mbetet në nivel deklarativ, pasi ai nuk ka shpjeguar cilat janë parimet dhe në cilat momente procedurale ka munguar zbatimi i tyre. Bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, parimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile mund të zbatohen në procesin e rivlerësimit, vetëm për çështje të parregulluara në mënyrë specifike nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Megjithatë, në shqyrtim të pretendimit të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni, për të vlerësuar nëse procedura e ndjekur ka qenë në përputhje me përcaktimet kushtetuese dhe ato të ligjit të posaçëm nr. 84/2016.
10. Nga tërësia e dokumentacionit të administruar në Komision dhe të shqyrtuar në Kolegj gjatë gjykimit, ka rezultuar se me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, trupi gjykues i Komisionit ka deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin dhe ka vendosur fillimin e hetimit administrativ. Subjektit të rivlerësimit, më datë 05.06.2018, i është bërë e njohur nëpërmjet postës së tij elektronike, përbërja e trupit gjykues dhe më datë 06.06.2018, subjekti ka konfirmuar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e këtij trupi. Me vendimin nr. 2, datë 19.06.2018, trupi gjykues ka vendosur përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit dhe njoftimin e tij për kalimin e barrës së provës mbi rezultatet e hetimit administrativ, për njohjen me provat e administruara nga Komisioni, si dhe për të drejtat e tij në lidhje me kërkimin e marrjes së provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve. Më datë 21.06.2018 (nëpërmjet postës elektronike), subjektit i

janë bërë të njohura rezultatet e hetimit administrativ dhe i është njoftuar kalimi i barrës së provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe i janë bërë të ditura të drejtat e tij për t'u njohur me materialet e dosjes, për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse, si dhe për të paraqitur shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, brenda një afati 12-ditor nga data e marrjes së njoftimit. Subjekti, më datë 25.06.2018, ka nënshkruar deklaratën për njohjen dhe marrjen e të gjithë dokumentacionit fizik dhe në formë elektronike të dosjeve të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti ka dërguar në Komision shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, nëpërmjet postës elektronike, më datë 02.07.2018, në të cilat ka kërkuar thirrjen e dëshmitarëve, për të vërtetuar të kundërtën, për secilën prej gjetjeve të Komisionit. Me vendimin datë 05.07.2018, trupi gjykues ka vendosur në mënyrë të arsyetuar, të refuzojë kërkesën e subjektit për thirrjen e dëshmitarëve, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ky vendim i është njoftuar rregullisht subjektit. Me vendimin nr. 3, datë 05.07.2018, trupi gjykues ka vendosur të ftojë subjektin në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Nëpërmjet postës elektronike, më datë 05.07.2018, subjektit i është njoftuar ftesa për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore më datë 11.07.2018, ora 10:00, si dhe i janë bërë të ditura të drejtat e tij. Në vazhdim të seancës dëgjimore, subjekti ka deklaruar se ka marrë të gjitha dokumentet, pjesë përbërëse e dosjes së tij të rivlerësimit dhe nuk ka kontestuar elemente procedurale të procedurës së hetimit të zhvilluar ndaj tij, apo elementë proceduralë të lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore. Në analizë të fakteve të përmendura si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në të gjithë procesin e rivlerësimit të realizuar nga Komisioni, subjektit i janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, si dhe janë respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor.

11. Paragrafët 12 dhe 13 të vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, të Komisionit, të cituar nga subjekti në shkaqet e ankimit, referojnë hapat proceduralë të ndjekur nga trupi gjykues, në respektim të ligjit nr. 84/2016. Është fakt që datat e cituara në vendim, nuk korrespondojnë me datat e sakta të akteve procedurale, por pavarësisht këtij gabimi material, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni e ka kryer procesin e rivlerësimit në përputhje të plotë me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016 dhe parimet e procesit të rregullt ligjor. Paragrafi 29.5 i vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, i Komisionit, i cituar nga subjekti, citon raportin e DSIK-së, por subjekti nuk shpjegon në ankim lidhjen e drejtpërdrejtë të këtij citimi me cenimin e parimeve të procesit të rregullt.
12. Në kuptim të parimit të arsytimit të vendimeve gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se vendimi i dhënë nga Komisioni në të gjithë arsyetimin e tij rendit faktet, rrethanat, provat dhe ligjin e zbatueshëm në analizën e çdo pasurie apo të ardhure të subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin e kontrollit të figurës, vendimi i Komisionit citon raportin e DSIK-së, opinionin ligjor të Prokurorisë së Përgjithshme, faktet dhe provat, duke arsyetuar mbi përmbajtjen e tyre për arritjen e konkluzionit përfundimtar në lidhje me këtë kriter. Vendimi nr. 35, datë 12.07.2018, i Komisionit është në përputhje të plotë me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, pasi ai përmban të gjitha elementet thelbësore të një vendimi. Duke e vlerësuar arsyetimin e vendimit të dhënë nga Komisioni, në këndvështrim të plotësisimit të elementeve të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese, duke pasur në konsideratë vendimin nr. 3, datë 26.01.2015 dhe vendimin nr. 63, datë 23.09.2015, të Gjykatës Kushtetuese, rezulton se ai përmban bazën ligjore mbi të cilën bazohet procesi i rivlerësimit, analizën e provave të administruara, vlerësimin e Komisionit në lidhje me hetimin administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe caktimin e masës disiplinore. Në vendim është bërë një analizë e plotë e provave, të cilat janë përdorur për konstatimin e situatës faktike për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe për kriterin e kontrollit të figurës. Për secilën pasuri apo të ardhur të hetuar, janë marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit

dhe janë reflektuar prapësimet e tij në lidhje me disa elemente të vlerësimit të tyre, si dhe janë dhënë shpjegimet për mospranimin e kërimit të provave me dëshmitarë, gjatë vlerësimit të të dyja kritereve.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

13. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur së bashku me ankimin aktet shkresore të mëposhtme, duke kërkuar që të merren në cilësinë e provës.

a) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.09.2018, e shtetasit A.K., në të cilën ai në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë Has për vitet 1992-1995, deklaron se në periudhën korrik 1994 - gusht 1995, Adriatik Cama, me detyrë hetues në Prokurorinë Has, ka banuar pa qira në një zyrë të përshtatur për ambient banimi në Komisaratin e Policisë, Kukës.

b) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.09.2018, e shtetasit A.K., në të cilën ai deklaron se ka jetuar së bashku me z. Adriatik Cama, në të njëjtën dhomë, me vendndodhje Enti Social-Kulturor i Ushtrisë, Tepelenë, për periudhën tetor 1992 deri në mesin e vitit 1994.

c) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.09.2018, e shtetasit B.M., banues në Sarandë, në të cilën ai deklaron se A.C., bashkëshortja e Adriatik Cama, është motra e bashkëshortes së tij dhe për këtë arsye, nga ana e familjes së z. Cama u janë huazuar para fëmijëve të tij që shkolloheshin në Tiranë e jetonin pranë banesës së z. Cama. Z. M. dhe bashkëshortja e tij, këto para ia kanë kthyer familjes Cama nëpërmjet sistemit bankar, brenda të njëjtit vit kalendarik.

ç) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.09.2018, e shtetasit M.D., në të cilën ai deklaron se apartamentin që ka pasur në pronësi në qytetin e Tepelenës, ia ka lënë në ruajtje e përdorim pa pagesë shtetasit Adriatik Cama, në fundvitin 1998 apo fillimvitin 1999 deri në fillimvitin 2004, për arsye të marrëdhënieve farefisnore me z. Cama dhe pasi ai vetë ka qenë emigrant në Greqi.

d) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.09.2018, e shtetasës V.C., nëna e subjektit të rivlerësimit, në të cilën ajo deklaron se përgjatë gjithë periudhës kohore nga 1992 e deri më sot, familja e saj i është gjendur afër familjes së djalit të saj Adriatik Cama, duke e ndihmuar ekonomikisht dhe duke e furnizuar atë sistematikisht me produkte bujqësore e blegtorale. Pas transferimit në qytetin e Tiranës në vitin 2004, ka vijuar ndihmesën, por jo sistematikisht, për shkak të largësisë.

14. Subjekti i rivlerësimit, në ankim ka shpjeguar se gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, ai ka kërkuar të thërriten si dëshmitarë personat, të cilët kanë lëshuar deklaratat e sipërpërmendura, por meqenëse kjo kërkesë nuk iu pranua, ai i ka paraqitur ato në cilësinë e provës, së bashku me ankimin. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kërkitimi i thirrjes si dëshmitarë, në vend të paraqitjes së deklaratave noteriale të këtyre shtetasve gjatë procesit në Komision, ka qenë një zgjedhje e lirë e subjektit në funksion të mbrojtjes së tij, prandaj pranueshmëria e këtyre provave do të analizohet në mbështetje të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së deklaratave noteriale të sipërcituara, rezulton se marrja e tyre është e panevojshme, pasi subjekti pretendon të provojë faktin e banimit pa qira e për pasojë t'i zbriten shpenzimet e qirasë nga shpenzimet e jetesës për periudhën 1992-2003. Por, siç rezulton nga arsyetimi i vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, të Komisionit, deklaratimet e subjektit në lidhje me banimin e tij

pa qira për këto periudha¹ janë konsideruar nga ana e Komisionit dhe në shpenzimet vjetore familjare të subjektit nuk janë llogaritur shpenzime qiraje. Deklarata noteriale e znj. V.C. rezulton se është e panevojshme, pasi ndihma në produkte ushqimore e blegtorale e dhënë prej saj për familjen e subjektit, megjithëse e pamundur të llogaritet konkretisht, duket të jetë e papërfillshme në raport me shpenzimet e jetesës së familjes së subjektit të rivlerësimit e sidomos kur, siç rezulton nga vendimi nr. 35, datë 12.07.2018, shpenzimet e jetesës së familjes së tij janë përlllogaritur nga Komisioni në vlerat minimale.

Deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.09.2018, të shtetasit B.M., subjekti nuk e ka trajtuar në shkaqet e ankimit dhe, për pasojë, trupi gjykues nuk është njohur me arsyet e paraqitjes së saj.

15. Bashkëlidhur parashtrimeve të paraqitura 5 ditë përpara shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit paraqiti fotografi të pasurisë së tij ambient ish-parkim/garazh të përshtatur në dyqan, me sipërfaqe 45,56 m², të blerë nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, rruga “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë. Trupi gjykues vlerëson se këto foto nuk pranohen në cilësinë e provës, pasi bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 49/2012, i ndryshuar), në këtë fazë të procesit, palët mund të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo fakte dhe prova të reja.
16. Subjekti në ankim ka kërkuar që të dëgjohet publikisht, duke kërkuar kështu shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e tij. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ligji nr. 49/2012, i ndryshuar, në nenin 51, pika 1, përcakton se gjykata në dhomë këshillimi vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon që debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja, ose vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë, ose me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsëritë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. Mbështetur në shqyrtimin e vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, të Komisionit, përmbajtjen e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, përmbajtjen e shkaqeve të ankimit dhe provave bashkëlidhur tij të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues çmoi se kërkesat e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar nuk përmbusheshin në rastin konkret dhe për këtë arsye vendosi të zhvillojë shqyrtimin e vendimit të Komisionit në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh.
17. Në Kolegj, më datë 12.10.2018, është regjistruar me nr. {***} prot., datë 12.10.2018, denoncimi i shtetasit P.B.. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi vlerësoi informacionin e dhënë, në përputhje me kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, vendosi për mosfillimin e hetimit kryesisht për këtë denoncim, pasi nuk përmbante shkaqe të mjaftueshme për të hetuar.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit, lidhur me situatën faktike dhe ligjin material për kriterin e vlerësimit të pasurisë

18. *Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se keqlllogaritjet e Komisionit mbi pambulueshmërinë e pasurisë me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij nuk mund të përbëjnë në asnjë standard vlerësimi, dyfishin e të ardhurave të*

¹ Vendimi nr. 35, datë 12.07.2018, faqe 16-17, paragrafët 22.12.2 – 22.16.

tyre familjare në 25 vite punë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në lidhje me secilën prej pasurive të paluajtshme e të luajtshme në mënyrë të detajuar e në përfundim, në faqen 39 të vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, të tij, shprehet: “30.13. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes arrin në përfundimin se: Subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Cama, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016”. Komisioni nuk është shprehur në konkluzionet e tij se pasuria e deklaruar e subjektit tejkalon dyfishin e pasurisë së ligjshme. Komisioni, në asnjë paragraf të vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, nuk ka cituar nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore: “1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”.

Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

19. *Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se nga një lexim e interpretim logjik i Aneksit të Kushtetutës dhe vetë ligjit nr. 84/2016 del qartë që subjekti i rivlerësimit mban përgjegjësi, vetëm nëse në deklaratën e dorëzuar për efekt të procesit të rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë, ka fshehur pasuri apo ka pasaktësi të qëllimshme në lidhje me pasuritë dhe burimet e krijimit të tyre dhe se nuk është aspak kushtetuese dhe ligjore që subjekti të mbajë përgjegjësi për deklarata të dhëna para 15 vjetësh, sa kohë që ato deklarata kanë qenë njëherë objekt kontrolli nga ILDKPKI-ja, që është institucioni i ngarkuar me ligj për kontrollin e tyre, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se dispozitat ligjore që rregullojnë vlerën e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në raport me përgjegjësinë disiplinore të subjektit të rivlerësimit, janë ato të neneve Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ato të ligjit nr. 84/2016. Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 kanë përcaktuar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si një masë të jashtëzakonshme e të përkohshme, e cila i referohet vlerësimit të integritetit të këtyre profesionistëve, nëse ata janë të përshtatshëm për të ushtruar funksionin e dhënies së drejtësisë.*
20. Komisioni i Venecias është shprehur në “Opinionin e ndërmjetëm” të tij për projektndryshimet kushtetuese për gjyqësorin në Shqipëri,² se domosdoshmëria e procesit të rivlerësimit shpjegohet me prezumimin se niveli i korrupsionit në gjyqësorin shqiptar është ekstremisht i lartë dhe se situata kërkon marrjen e masave urgjente e radikale dhe një mjet i tillë mund të shihet si i përshtatshëm në kontekstin shqiptar, për sa kohë mbetet një masë e jashtëzakonshme dhe e përkohshme. Të njëjtin qëndrim ky Komision e ka shprehur edhe në “Opinionin final” për projektndryshimet kushtetuese³, në të cilin shprehet se: “Sa u përket masave të jashtëzakonshme për gjykatësit dhe prokurorët, Komisioni i Venecias mbetet i mendimit se masat e tilla jo vetëm që janë të justifikuar, por janë të domosdoshme që Shqipëria të mbrohet nga trazirat e korrupsionit, të cilat nëse nuk trajtohen, mund të shkatërrojnë plotësisht sistemin”. Guida operationale e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (2006)⁴ për procesin e *vetting*-ut e përkufizon atë si vlerësim të integritetit të individit, me qëllim përcaktimin e përshtatshmërisë së tij për punësim në

² CDL-AD(2015)045 Opinioni i Ndërmjetëm lidhur me Projekt Amendamentet Kushtetuese për Gjyqësorin në Shqipëri (i miratuar nga Komisioni i Venecias në dhjetor 2015).

³ CDL-AD(2016)009 Opinioni Final lidhur me Projekt Amendamentet Kushtetuese për Gjyqësorin në Shqipëri (i miratuar nga Komisioni i Venecias në mars 2016).

⁴ United Nations, *Rule-of-Law Tools for Post-Conflict States: Vetting: An Operational Handbook* (United Nations 2006).

sektorin publik. Individët, që gjenden me mungesë integriteti bazuar në përkatësitë, sjelljet ose veprimet e tyre të mëparshme ose me mungesa serioze lidhur me kriteret e aftësisë, janë të detyruar të largohen nga pozicionet e tyre, si dhe nuk lejohen të marrin pozicione të reja.

21. Parimin e drejtësisë tranzitore dhe parimin e sipërpërmendur të *vetting*-ut e kanë sanksionuar edhe përcaktimet e Kushtetutës. Kështu, në nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, përcaktohet: “4. Komisioni ose Kolegji i Apelit, sipas rastit, përmes personelit të tyre, Komisionerit Publik ose vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Komisioni, Kolegji dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të drejtpërdrejtë në të gjitha bazat e të dhënave qeveritare, përveç atyre që janë klasifikuar “sekret shtetëror”, duke përfshirë edhe dosjet personale të të rivlerësuarit, të dhënat statistikore, dosje të përzgjedhura për rivlerësim, vetëvlerësimet, mendimet e eprorëve, të dhënat për trajnimet dhe ankimet ndaj të rivlerësuarve, rezultatet e verifikimit të ankesave, vendimet për marrjen e masave disiplinore ndaj të rivlerësuarve, të dhënat për pronat e të rivlerësuarit, llogaritë bankare, të dhënat tatimore, të dhënat për automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi, si dhe çdo dokument tjetër të dobishëm. Komisioni, ose Kolegji, mund të urdhërojë individë dhe shoqëri tregtare të dëshmojnë ose të japin prova në përputhje me ligjin.” Rezulton se vetë Kushtetuta ka parashikuar kontrollin për të shkuarën e subjektit të rivlerësimit, me qëllim që, siç ajo vetë përcakton në nenet D, Dh dhe E, të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur; ata që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; ata të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre, si dhe ata që kanë mangësi profesionale të cilat nuk mund të korrigjohen përmes edukimit. Në të tria kriteret e tij, rivlerësimi bazohet në veprime dhe qëndrime të subjektit të rivlerësimit në të shkuarën: aftësia e tij profesionale nuk vlerësohet për çështje që janë shqyrtim⁵, por periudha e vlerësimit përfshin tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës, ose nga 1 janari 2006⁶ e në vazhdim; deklarata e figurës vlerësohet nëse është plotësuar me vërtetësi për periudhën nga data 1 janar 2012 e deri në ditën e deklarimit⁷; pasuria vlerësohet duke marrë në shqyrtim pasuritë e akumuluar në vite.
22. Kontrolli i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, i parashikuar në normat e Aneksit të Kushtetutës, justifikohet me interesin e lartë publik të shprehur në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, i cili është garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Subjekti i rivlerësimit, për të tria kriteret objekt vlerësimi: pasuror, të figurës dhe profesional, plotëson një deklaratë të re, ashtu siç parashikohet në nenet e sipërcituara të Kushtetutës. Deklarata e re e plotësuar për efekt të procesit të rivlerësimit për secilin prej kriterëve, shërben si pikënisje e këtij procesi dhe deklaratimet e subjektit ballafaqohen me të dhënat e mbledhura nga organet e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të neneve 45-52 të ligjit nr. 84/2016.
23. Në lidhje me procesin e vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Ndërsa sipas nenit 32, pika 5, deklaratimet e interesave privatë dhe

⁵ Neni “E”, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

⁶ Neni 41, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016.

⁷ Neni Dh, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Bazuar në këto përcaktime kushtetuese dhe ligjore, rezulton se deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit nuk është dokumenti i vetëm, i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit ose Kolegjit, por deklaratat e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë prej tij. Deklarata e pasurisë së rivlerësimit ka të njëjtën përmbajtje me deklaratat periodike të pasurisë, me ndryshimin se në këtë deklaratë subjekti duhet të bëjë një pasqyrim të të gjitha pasurive të akumuluar në vite. Kontrolli dhe krahasimi i deklaratave të mëparshme me deklaratën e pasurisë, gjatë vlerësimit të pasurisë, është i domosdoshëm, pasi u shërben organeve të rivlerësimit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratave të subjektit në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi mjaftueshmërinë e deklaratave të tij apo ligjshmërinë e të ardhurave të tij në vite, si dhe të burimeve të krijimit të pasurisë. Sidomos, në rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, vlerësimi i deklaratave të mëparshme merr rëndësi të veçantë, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri.

24. Subjekti i rivlerësimit, deklaratën e pasurisë së rivlerësimit do të duhet ta plotësojë me një kujdes të posaçëm dhe me vërtetësi. Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, që nga momenti i hyrjes në fuqi të tij ka pasur të qartë përgjegjësinë ligjore për subjektet e deklarimit dhe personat e lidhur me ta, si dhe sanksionet përkatëse, në rast të mosplotësimit me vërtetësi të deklaratës së pasurisë. Ligji nr. 84/2016, duke e përcaktuar procesin si rivlerësim dhe duke vendosur në bazë të procesit vetëdeklarimin e subjekteve, në frymën e tij, por edhe në përcaktimet e neneve 32, pika 5 dhe 33, pika 1 nuk ka si qëllim zhbërjen e legjislacionit në fuqi për deklarimin e kontrollin e pasurive, por përkundrazi synon realizimin e kontrollit të pasurisë së deklaruar në deklaratat periodike dhe në deklaratën e rivlerësimit, si një kontroll të bazuar në deklaratat në vazhdimësi të subjekteve të rivlerësimit.
25. Nëse deklarata e pasurisë së rivlerësimit është hartuar me saktësi dhe vërtetësi, por në deklaratat e mëparshme në lidhje me të njëjtën pasuri subjekti ka paraqitur deklarime të pasakta, deklarime të rreme dhe/ose fshehje pasurie, këto deklarime të shkuara shërbejnë si provë për të përcaktuar përgjegjësinë e subjektit në raport me zbatimin e legjislacionit në fuqi. Për këtë arsye, neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 u ka njohur vlerën e provës, deklaratave periodike të pasurisë. Sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, provat janë të dhëna që vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces. Në këtë kuptim, ligji nr. 84/2016, duke u dhënë deklaratave të mëparshme të pasurisë vlerën e provës, i ka çmuar ato me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për vlerësimin e kriterit të pasurisë.
26. Objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, materializohet edhe në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaratave të subjektit në deklaratat periodike dhe atë të rivlerësimit, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të (pasuri e paluajtshme/e luajtshme/likuiditete). Ligji nr. 84/2016 në nenin 61, pika 3 ka përcaktuar se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur rezulton se subjekti ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. Në vijim të analizës dhe interpretimit të dispozitave ligjore si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit

vlerëson se sipas ligjit nr. 84/2016, pamjaftueshmëria e deklaramit për deklarimet e mëparshme periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklaramit të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklaramit të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t'u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklaramit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

27. Për pasurinë e subjektit të rivlerësimit apartament me sipërfaqe 76,73 m², rruga “{***}”, ndërtesa {***}, hyrja {***}, apartamenti {***}, Tiranë (në vijim apartamenti 76,73 m²), Komisioni ka konkluduar se:
- referuar deklaratës së vitit 2003 dhe deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit;
 - subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, në vlerën 1086315 lekë.
28. *Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, ai ka bërë deklaramit të saktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me vlerën e apartamentit 76,73 m², pasi ka deklaruar çmimin e vërtetë që ka paguar te shoqëria ndërtuese dhe se Komisioni ka rrëzuar pa të drejtë kërkesën e subjektit për të marrë dëshminë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, sidomos kur deklaratën noteriale të shtetasit R.Z., administrator i kësaj shoqërie, e ka konsideruar fiktive e për këtë arsye, ai kërkon që kjo dëshmi të merret nga Kolegji, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se gjatë hetimit administrativ në Komision kanë rezultuar faktet si më poshtë.*
29. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se vlera e apartamentit 76,73 m² është 3400000 lekë. Ky apartament rezulton se është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2003, me vlerën 2400000 lekë.
- Nga verifikimi i kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme (apartament banimi me sipërfaqe 76,73 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 15,18 m²), me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.04.2012, me palë blerëse Adriatik dhe A.C. dhe palë shitëse shoqëria “{***}” ShPK, e përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori R.Z., rezulton se sipas nenit 3 të saj, palët kanë rënë dakord që çmimi për sipërfaqen e banimit 76,73 m² është në vlerën 29157 USD dhe për sipërfaqen e përbashkët prej 15,18 m² është 5768 USD; pagesa për këtë apartament është bërë që në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë, në vitin 2003, dhe palët nuk kanë asnjë detyrim të ndërsjellë midis tyre.
- Nga përmbajtja e kontratës, si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se çmimi i paguar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003 është 34.925 USD, jo 3400000 lekë sa ka deklaruar subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe as 2400000 lekë sa ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003.
30. Shoqëria “{***}” ShPK, në informacionin e përcjellë Komisionit⁸, konfirmon se midis saj dhe shtetasit Adriatik Cama është lidhur kontratë sipërmarrjeje dhe kontratë e shitblerjes për apartamentin 76,73 m², në adresën rruga “{***}”, dhe pagesat e blerësit për këtë pasuri janë bërë në cash dhe të gjitha të dhënat janë pasqyruar në mandatpagesat, në bilancet e shoqërisë në vite. Bashkëlidhur këtij informacioni, shoqëria “{***}” ShPK ka paraqitur kontratë shitblerjeje të

⁸ Protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 24.05.2018.

pasurisë së paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.04.2012, por nuk ka paraqitur kontratën e pretenduar të sipërmarrjes. Shoqëria “{***}” ShPK ka paraqitur gjithashtu edhe deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.10.2012, të nënshkruar nga shtetasi R.Z., i cili deklaron: “[...] jam ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, ku me z. Adriatik Cama kam lidhur kontratë sipërmarrjeje midis palëve, më datë 1.12.2003, me vlerë prej 27.000 USD, për këtë apartament në rrugën “{***}”, Tiranë, [...]. Deklaroj se nga ana e z. Adriatik Cama kam marrë shumën prej 2.400.000 lekësh, të shtrirë në një kohë nga fundi i vitit 2002 deri në fillim të vitit 2003. Sipas kërkesës së porositësit, meqenëse në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, çmimi për m² i banesave kishte pësuar një rritje të konsiderueshme, në kontratën e sipërmarrjes nuk u vendos vlera reale e lekëve që më ishin dhënë, por çmimi prej 27.000 USD për të justifikuar rritjen faktike të çmimit nga momenti i lëvrimin të lekëve deri në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes së lidhur mes nesh. E hartoj këtë deklaratë noteriale me kërkesën e porositësit Adriatik Cama, për ta paraqitur pranë ILDKP, Tiranë”.

31. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të kalimit të barrës së provës nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se diferenca prej 395.998 lekësh nga çmimi real i shitjes së banesës prej 3.400.000 lekësh, i likuiduar nga ana e tij në dhjetor të vitit 2003, me atë të pasqyruar në kontratën e shitblerjes së datës 11.04.2012, nuk është paguar asnjëherë të shoqëria ndërtuese. Sipas marrëveshjes së bërë me shoqërinë ndërtuese në momentin e blerjes së banesës në vitin 2003, kryerjes së pagesës së menjëhershme nga ana e tij në fundin e dhjetorit 2003 dhe vonesave në regjistrimin e kësaj pasurie në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme prej shoqërisë ndërtuese, atij as i është kërkuar që të mbulohet kjo diferencë dhe as nuk e ka paguar ndonjëherë. Subjekti deklaron se kontratën e sipërmarrjes/prenotimit të apartamentit nuk ka mundur ta gjejë dhe, për rrjedhojë, nuk mundet ta paraqesë në cilësinë e dokumentacionit justifikues.
32. Subjekti ka kërkuar pyetjen e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, z. R.Z., për të vërtetuar se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ai ka paraqitur me saktësi dhe vërtetësi vlerën e blerjes së apartamentit 76.73 m² në shumën prej 3.400.000 lekësh, e cila është një vlerë e ndryshme nga ajo që palët kanë deklaruar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie. Kërkesa e sipërcituar është refuzuar nga trupi gjykues i Komisionit me vendimin e datës 05.07.2018, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, me arsyetimin se Komisioni ka konstatuar se shtetasi R.Z. edhe më parë ka bërë deklarata në favor të subjektit të rivlerësimit, me qëllim “korrigjimin/ndryshimin” e çmimit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes dhe justifikimin e çmimit të deklaruar të blerjes së këtij apartamenti në ILDKPKI nga subjekti i rivlerësimit, prandaj e ka vlerësuar kërkesën si të bërë me qëllim zvarritjen e gjykit.
33. Duke analizuar rrethanat e pasqyruara më lart, me qëllim shqyrtimin e pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni i ka refuzuar pa të drejtë kërkesën për pyetjen e shtetasit R.Z., në cilësinë e dëshmitarit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.10.2012, e shtetasit R.Z. nuk ka fuqi provuese, për sa kohë kjo deklaratë e redaktuar në favor të subjektit të rivlerësimit kundërshtohet tërësisht prej vetë atij, nëpërmjet shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ. Deklarata noteriale është redaktuar më datë 01.10.2012, në një kohë kur palët “{***}” ShPK dhe subjekti i rivlerësimit kishin nënshkruar rreth 6 muaj më parë, më datë 11.04.2012, kontratën e shitblerjes për të njëjtin apartament, me çmim të ndryshëm. Në këtë deklaratë, administratori i shoqërisë “{***}” ShPK deklaron se porositësi i ka paguar atij deri në fillim të vitit 2003 shumën 2.400.000 lekë, ndërsa në kontratën e shitjes palët deklarojnë se çmimi i paguar deri në dhjetor 2003 është 34.925 USD. Kuptohet qartë, që hartimi i kësaj deklaratë

noteriale është kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, me qëllim që gjatë kontrollit të kryer në vitin 2012 nga ILDKPKI-ja, të justifikonte vlerën prej 2.400.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003 si çmim blerjeje të apartamentit 76,73 m².

34. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë shkresore për të vërtetuar pagimin e shumës 3.400.000 lekë në vitin 2003 dhe as nuk ka shpjeguar në asnjë moment gjatë procesit të rivlerësimit në Komision e as në ankim, se përse në kontratën e shitblerjes ka deklaruar me vullnet të plotë se ka paguar një shumë më të madhe nga sa ka pretenduar se ka paguar realisht, në një kohë kur kontrata e shitblerjes është hartuar në vitin 2012, ndërsa çmimi është paguar i plotë që në vitin 2003. Pra, subjekti i kishte të gjitha mundësitë që në kontratë të deklaronte çmimin real të paguar prej tij, kundrejt shoqërisë “{***}” ShPK. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë vendimin e Komisionit për refuzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pyetjen e shtetasit R.Z., në cilësinë e dëshmitarit.
35. Në shqyrtim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim, për marrjen nga Kolegji të dëshmisë së shtetasit R.Z., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në kontratën noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.04.2012, për apartamentin 76,73 m², palët kanë deklaruar me vullnet të plotë se në favor të shoqërisë “{***}” ShPK është paguar nga subjekti i rivlerësimit shuma 34.925 USD. Në kuptim të nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton se: *Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj, i lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se: Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar*, kontrata noteriale e shitblerjes e sipërcituar përbën provë të plotë. Subjekti kërkon të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, e cila përbën provë të plotë, duke thirrur si dëshmitar palën tjetër kontraktore. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të mos pranojë kërkesën e subjektit për marrjen e dëshmisë së shtetasit R.Z., sepse bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, ky mjet prove është tërësisht i papërshtatshëm, për shkak të qëndrimeve kontradiktore që ky shtetas, në cilësinë e administratorit të shoqërisë sipërmarrëse, ka mbajtur në deklaratimet e tij, në lidhje me çmimin e paguar nga subjekti i rivlerësimit për apartamentin 76,73 m². Gjithashtu, bazuar në nenin 49, pika 6, fjalia e parë e ligjit nr. 84/2016, marrja e kësaj prove tejkalon kufijtë e lejuar nga ligji për provën me dëshmitarë, të përcaktuar në nenin 232 të Kodit të Procedurës Civile: *Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë.*
36. Për sa i përket çmimit të blerjes së apartamentit 76,73 m², trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përkatësisht: në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit vlerën 3.400.000 lekë; në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2003 vlerën 2.400.000 lekë; në deklaratën noteriale të administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK në vitin 2012 vlerën 27.000 USD; në kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.04.2012, vlerën 34.925 USD.

Në konkluzion të arsytimit të mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me vlerën e blerjes së apartamentit 76,73 m² në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2003, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për këtë arsye, pretendimi i tij është i pabazuar.

37. *Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se në arsytimin e Komisionit renditen pa konkludim apo interpretim konkret dualizimi i firmave ndërtuese apo ndryshimet e emërtimeve të adresës së apartamentit 76,73 m², ndërkohë që subjekti ka shpjeguar dhe provuar saktë se ky apartament është ndërtuar vetëm nga shoqëria “{***}” ShPK, kurse pasqyrimi i adresave të ndryshme në deklaratat periodike të pasurisë ka ndodhur vetëm për të deklaruar adresën më të saktë të mundshme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton nga aktet e administruara, se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar si adresë për apartamentin 76,73 m²: Njësia Bashkiake nr. {***}, rruga “{***}”, Bashkia Tiranë (ose rruga “{***}”, Ndërtesa {***}, Hyrja {***}, Ap. {***}, Tiranë). Në pyetësin drejtuar subjektit, Komisioni e informon se ka konstatuar që në disa dokumente të ndryshme, si: deklarata periodike/vjetore e dorëzuar në ILDKPKI, kontrata kredie, gjendje llogarie etj., adresa e apartamentit 76,73 m² duket se është deklaruar në mënyra të ndryshme. Pasi liston adresat e ndryshme të vetëdeklaruar nga subjekti, Komisioni i kërkon atij të konfirmojë nëse këto adresa i referohen së njëjtës pasuri të paluajtshme apo disa pasurive me adresa të ndryshme, bazuar edhe në informacionin e përcjellë në Komision, me shkresë nr. {***} prot., datë 22.05.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila informon se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij, sipas Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile figurojnë të jenë regjistruar banorë në Zyrën e Gjendjes Civile të Njesisë Bashkiake nr. {***}, Bashkia Tiranë, ndërsa përpara datës 05.11.2007 rezultojnë të regjistruar sipas transkriptimeve, në Zyrën e Gjendjes Civile të Njesisë Bashkiake nr. 9, Bashkia Tiranë. Në përgjigjet e përcjella në Komision më datë 28.05.2018, subjekti shpjegon se bëhet fjalë për të njëjtën pasuri të paluajtshme, por duke qenë se zona ka qenë në zhvillim e sipër dhe sistemi i adresave ka ndryshuar vazhdimisht, ai është detyruar, edhe për saktësi, të deklarojë adresa të ndryshme, ndërsa regjistrimin për herë të parë në Tiranë e ka bërë në Njësinë nr. {***}, për shkak se banesa që ka aktualisht, në atë periudhë ishte zonë informale dhe nuk e kishte statusin e vendbanimit. Të njëjtat shpjegime, subjekti i ka paraqitur edhe në përgjigje të barrës së provës për rezultatet e hetimit administrativ.*
38. Në vendimin nr. 35, datë 12.07.2018, Komisioni shprehet se evidentimet për deklaramet e ndryshme të subjektit në lidhje me adresën e apartamentit dhe shoqërinë ndërtuese të tij “[...] nuk kanë të bëjnë me gjetje që ndikojnë në kriterin e vlerësimit pasuror dhe që të rëndojnë pozitën e subjektit, por thjesht janë konstatime që kanë të bëjnë me hetimin administrativ të kryer nga ana jonë, për konfirmimin e pasurisë apartament dhe vendndodhjes së tij, të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit. Bazuar në vetëdeklarimin e subjektit, si edhe në dokumentacionin e administruar në dosje, nga ana e këtij Komisioni është krijuar bindja se kemi të bëjmë me të njëjtin apartament, të ndodhur në të njëjtën adresë, i prenotuar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003.”⁹
39. Në analizë të fakteve të sipërcituara, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në ndryshim nga sa pretendon subjekti, Komisioni ka shpjeguar në vendim arsyet për kryerjen e veprimeve hetimore përkatëse, në lidhje me vendndodhjen dhe shoqërinë ndërtuese të pasurisë apartament 76,73 m²,

⁹ Paragrafët 22.9.4 dhe 22.9.5 të vendimit nr. 35, datë 12.07.2018.

për të konkluduar se bëhej fjalë vetëm për një pasuri të deklaruar në adresa të ndryshme, pa e ngarkuar subjektin me përgjegjësi.

Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

40. *Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se në llogaritjen e të ardhurave për periudhën kohore para vitit 1997, Komisioni pa të drejtë nuk ka marrë parasysh shpërblime të tjera të ligjshme të punës së prokurorit, si: shpërblimi i orëve jashtë orarit, i gatishmërive dhe të tjera kompensime financiare të ligjshme dhe se në shpenzimet e jetesës deri në fund të vitit 2003, Komisioni nuk ka zbritur akomodimin falas në institucione shtetërore apo te të afërmit e subjektit, si dhe ndihmesën në produkte ushqimore të familjarëve të tij, për rrjedhojë të ardhurat e krijuara nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes së tij në vite justifikojnë tërësisht blerjen e apartamentit 76,73 m², trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për pasurinë apartament 76,73 m² të ardhurat e krijuara nga paga e tij dhe e bashkëshortes në vite. Gjatë hetimit administrativ, subjekti, në mungesë të kontratës së sipërmartjes për apartamentin 76,73 m² me shoqërinë “{***}” ShPK, ka pretenduar se çmimin e plotë për blerjen e tij e ka shlyer në dhjetor 2003. Komisioni, në vendimin nr. 35, datë 12.07.2018, arsyeton se për efekt të vlerësimit të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, janë llogaritur shpenzimet minimale të jetesës sipas përbërjes familjare të subjektit, nga tetori i vitit 1992 deri në fund të vitit 2003, duke arritur në konkluzionin se ato kanë qenë në vlerën prej 2.176.786 lekësh. Pasi i është kaluar barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendime mbi evidentimin e saktë të përbërjes së tij familjare në vite e cila ka ndikuar në vlerën e shpenzimeve të llogaritura, për pasojë nga Komisioni është ulur vlera e tyre, duke reflektuar ndryshimet përkatëse në analizën financiare. Nga verifikimi i të dhënave sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka bërë rilogaritje, bazuar në prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe vlera e shpenzimeve minimale të jetesës nga vlera 2.448.786 lekë, sipas rezultateve të hetimit paraprak, është rilogaritur në vlerën 2.176.786 lekë, në të cilën nuk janë përfshirë shpenzime për pagesë qiraje për periudhën 1992-2003.*
41. *Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka provuar se është në pamundësi objektive për të vërtetuar pagat e përfituara gjatë periudhave kohore 15.10.1992-14.07.1994¹⁰ dhe 10.09.1995-31.08.1997¹¹, për shkak se arkivat e institucioneve që përmbanin dokumentacionin e llogarive përkatëse janë djegur gjatë trazirave të vitit 1997. Në vendimin nr. 35, datë 12.07.2018¹², Komisioni sqaron se pagat e subjektit për periudhën 1992-1994 i ka përlllogaritur duke iu referuar vërtetimeve të pagave të paraqitura në dosjet e ILDKPKI-së, nga subjekte të tjera të rivlerësimit që kanë kryer funksionin e prokurorit për periudhën në fjalë. Ndërsa për periudhën 1995-1997, pagat i ka përlllogaritur duke marrë si bazë vlerën mesatare të pagës neto të muajit gusht 1995 dhe muajit shtator 1997. Në ankim, subjekti pretendon se në këto përlllogaritje Komisioni, pa të drejtë, nuk ka marrë parasysh shpërblime të tjera të ligjshme të punës së prokurorit, si: shpërblimi i orëve jashtë orarit, i gatishmërive dhe të tjera kompensime financiare të ligjshme, të cilat kanë ndikuar në konkluzionin e Komisionit se të ardhurat e krijuara nga paga e tij dhe e bashkëshortes së tij në vite nuk justifikojnë tërësisht blerjen e apartamentit 76,73 m².*

¹⁰ Vërtetim, datë 13.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjirokastrë.

¹¹ Vërtetim, nr. 469/1 prot., datë 12.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë.

¹² Faqja 15 e vendimit nr. 35, datë 12.07.2018.

42. Trupi gjykues i Kolegjit, në shqyrtim të pretendimit të mësipërm, vlerësoi mundësinë financiare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij për të blerë pasurinë apartament 76,73 m² dhe për të krijuar kursimet e deklaruara *cash* në vlerën 600.000 lekë për periudhën tetor 1992 - dhjetor 2003, bazuar në deklarinimin e subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit se si burim krijimi të kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

Trupi gjykues i Kolegjit e ka konsideruar të drejtë mënyrën e përlllogaritjes së pagave të subjektit nga Komisioni për periudhat kohore 15.10.1992-14.07.1994 dhe 10.09.1995-31.08.1997, përlllogaritje e pakundërshtuar edhe nga subjekti i rivlerësimit në ankim. Me qëllimin e një analize sa më të drejtë të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë dhe, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor ka përlllogaritur një shtesë në masën 66% mbi totalin e pagave të përfituara për periudhat kohore të sipërcituara, e cila përfshin shpërblimin e orëve jashtë orarit, gatishmërive dhe të tjera kompensime financiare të ligjshme, për shkak të detyrës së prokurorit, duke marrë si bazë në përcaktimin e kësaj mase raportin e shpërblimeve me pagën që ka marrë subjekti në periudhën korrik - dhjetor 1994¹³. Të ardhurat e subjektit sipas përlllogaritjeve të Komisionit kanë qenë në total, në vlerën 5.235.786 lekë. Pas llogaritjes së bërë nga trupi gjykues i Kolegjit nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, si rezultat i shtesës prej 66%, vlera në total e pagave të tij është 5.638.577 lekë. Shuma e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit (në vlerën 5.638.577 lekë) dhe të bashkëshortes së tij (në vlerën 550.773 lekë), bazuar në përlllogaritjet e pasqyruara më sipër dhe në të dhënat për pagat sipas dokumentacionit provues të administruar nga institucionet përkatëse shtetërore rezultojnë të jetë në vlerën 6.189.350 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit e ka konsideruar të drejtë dhe objektive përlllogaritjen e Komisionit në vlerën 2.176.786 lekë, për shpenzimet për konsum familjar të kryera nga familja Cama. Ndryshimi i pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme është përlllogaritur në vlerën totale 4.696.015 lekë, ku përfshihen: i) blerje autoveturë në vlerën 300.000 lekë; ii) likuiditete në banesë në vlerën 600.000 lekë; iii) blerje e pasurisë së paluajtshme apartament 76,73 m² në vlerën 3.796.015 lekë¹⁴.

Në përfundim të analizës së të dhënave të pasqyruara si më sipër, rezultojnë se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 683.451 lekë. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk mund të krijojte kursime *cash* në banesë në vitin 2003, si dhe nuk justifikon me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurisë apartament 76,73 m² për periudhën janar 1992-dhjetor 2003, në vlerën 683.451 lekë.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament 76,73 m² në rrugën “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë *pretendimi i tij është i pabazuar*.

43. **Për pasurinë e subjektit të rivlerësimit ambient ish-parkim/garazh të përshtatur dyqan, me sipërfaqe 45,56 m², të blerë nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, rruga “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë (në vijim: dyqani nr. 1), Komisioni ka konkluduar se:**

- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në shumën prej rreth 650.000 lekësh;

¹³ Referuar vërtetimit nr. {***} prot. H.D., datë 18.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës, të ardhurat për periudhën korrik 1994 – dhjetor 1994 kanë qenë 104.272 lekë (minimumi përfituar në muajin korrik: 10.348 lekë dhe maksimumi përfituar në muajin nëntor: 20.177 lekë); shuma e përfituar mesatarisht në muaj, ka qenë 18.958 lekë; nga raporti: 18.958 lekë/11.400 lekë (paga bazë që deklaroi subjekti), rezultojnë se për gatishmëri, shpërblime etj. i është paguar shtesë 66% e pagës.

¹⁴ Sipas kursit mesatar të këmbimit për vitin 2003: 1 USD = 108,69 lekë.

- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve për vitin 2009, në vlerën 528429 lekë.

44. *Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit, se ai ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë dyqan nr. 1, është rrjedhojë e një arsytimi të gabuar dhe jologjik mbi provat e marra gjatë shqyrtimit administrativ, pasi gjendjen cash të deklaruar nga subjekti në vitet 2003 e 2004, gjithsej 1.000.000 lekë, duke qenë se nuk është deklaruar në vitin 2005 deri në vitin 2008, Komisioni e ka deduktuar si të përdorur ose të harxhuar përgjatë vitit 2005, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti deklaroi si burim krijimi për pasurinë dyqan nr. 1 të ardhurat familjare të deklaruara, një kredi në shumën 1.000.000 lekë në Raiffeisen Bank (e shlyer), si dhe huamarrje në shumën 6.000 euro (hua e cila është shlyer). Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2009 ka deklaruar si burim krijimi për të njëjtën pasuri, të ardhurat e krijuara në vite të deklaruara më parë, të ardhurat nga paga vjetore e tij dhe e bashkëshortes, tërheqjen nga llogaria e kredisë MIDAS në Raiffeisen Bank të sasisë prej 600.000 lekësh më datë 08.05.2009, si dhe huamarrje prej 6.000 eurosh shtetasit N.S., më datë 02.05.2009. Nga verifikimi i kontratës së sipërmarrjes prenotim dhe dorëzim dyqani nr. 1, nëntokë, sipërfaqe totale 45,56 m², e lidhur më datë 15.05.2009, me palë porositëse Adriatik Cama dhe palë sipërmarrëse shoqëria “{***}” ShPK, e përfaqësuar nga ortaku i vetëm R.Z., rezultoi se çmimi i blerjes së dyqanit është 17.870 euro dhe pala porositëse Adriatik Cama ka deklaruar se dyqanin e ka marrë në dorëzim në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, më datë 15.05.2009. Shoqëria “{***}” ShPK, në informacionin e protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 24.05.2018, konfirmon kontratën e sipërmarrjes për dyqanin nr. 1 dhe bashkëlidhur ka paraqitur edhe një mandatarkëtim me pages Adriatik Cama kundrejt “{***}” ShPK, në shumën 17.870 euro për blerje lokale, ish-parkim. Mandatarkëtimi i nënshkruar nga administratori R.Z. mban vulën e shoqërisë dhe datën 08.04.2009.*
45. Sipas informacionit me nr. {***} prot., datë 23.01.2018, të përcjellë në Komision nga Banka Raiffeisen, subjekti i rivlerësimit ka marrë kredi në këtë bankë, në vlerën 1.000.000 lekë më datë 07.05.2009, e cila është disbursuar më datë 08.05.2009. Sipas deklaratës të vetë subjektit, si dhe sipas deklaratës të shtetasit N.S. me deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2012, borxhin prej 6.000 eurosh, subjekti e ka marrë më datë 02.05.2009. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit deklaroi se dyqani nr. 1 është blerë nga ai në momentin e dorëzimit nga shoqëria “{***}” ShPK, më datë 15.05.2009. Por, përveç kontratës së sipërmarrjes, e cila nuk shprehet për mënyrën dhe kohën e pagimit të çmimit, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë pagimin e tij në datën 15.05.2009. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se fakti i kryerjes së pagesës më datë 08.04.2009, i provuar me mandatarkëtimin e shoqërisë “{***}” ShPK, nuk është konsideruar nga Komisioni në analizën e tij për vlerësimin e pasurisë dyqan nr. 1, ndërsa çmon se ky mandatarkëtim përmban të gjitha elementet e mjaftueshme për t’u konsideruar si një provë relevante për zgjidhjen e drejtë të momentit të kryerjes së pagesës për blerjen e kësaj pasurie. Në përfundim të analizës së këtyre elementeve faktike, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka paguar çmimin e dyqanit nr. 1, pa pasur ende disponibël një pjesë të burimeve financiare që i ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, konkretisht kredinë e marrë në Raiffeisen Bank dhe huan nga shtetasi N.S.
46. Me qëllim justifikimit të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, në rezultatet e hetimit administrativ, si dhe në ankim, subjekti ka argumentuar se në deklaratën e pasurisë së

vitit 2009 ka deklaruar si burim të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, ndër të tjera, edhe të ardhurat e krijuara në vite të deklaruara më parë. Në vitet 2003 dhe 2004 ka deklaruar gjendje të likuiditeteve jashtë sistemit bankar në vlerat 600.000 lekë dhe 400.000 lekë, por duke mos deklaruar gjendje likuiditetesh në deklaratat e viteve 2005-2008, Komisioni pa të drejtë ka deduktuar se këto likuiditete janë përdorur si shtim pasurie apo janë harxhuar gjatë vitit 2005. Në deklaratimet e pasurisë në vitet 2005-2008, këto likuiditete nuk janë rideklaruar nga ai si gjendje *cash* në banesë, duke vlerësuar se ishin deklaruar një herë dhe nuk mund të deklaroheshin përsëri si shtesa, pasi në deklarinimin periodik vjetor duhet të pasqyroheshin vetëm shtesat e pakësimet e pasurive, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarinimit. Nga shqyrtimi i hollësishëm i deklaratave periodike në vite, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me likuiditetet *cash* në banesë, ka qenë:

- Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003: Lekë në gjendje *cash*, vlera 0,6 milion. Burimi: Të ardhurat nga paga.
- Në deklaratën e pasurisë së vitit 2004: Gjendje *cash* në lekë, vlera 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Data dhe viti i krijimit të pasurisë: 2004.
- Në deklarinimet e viteve 2005-2013, subjekti nuk ka deklarime mbi likuiditetet *cash*.
- Në deklaratën e vitit 2014: Gjendje *cash* në banesë nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes, si dhe nga kredia e marrë në Credins Bank, vlera 400.000 lekë.
- Në deklaratën e vitit 2015: Gjendje në *cash* në banesë nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes, nga qiraja e ambientit ish-garazh; vlera 300.000 lekë.
- Në deklaratën e vitit 2016: Shtim pasurie: gjendje në *cash* në banesë nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes, nga disbursimi i kredisë bankare në bankën Credins me nr. 560 kontrate, datë 13.12.2016, nga qiraja e ambientit ish-garazh; vlera: 1.450.000 lekë.
- Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit: Para *cash* në banesë në shumën 1.450.000 lekë. Burim krijimi: Nga kredia e marrë në Credins Bank në vitin 2016. Vlera: 1.450.000 lekë.

47. Nga deklarinimet e mësipërme rezulton se subjekti ka deklaruar gjendjet e *cash*-it për çdo vit, pra sasinë e parave që ka pasur në banesë më datë 31 dhjetor të vitit përkatës dhe jo shtesat apo pakësimet e tij. Nëse do të ndiqej logjika e pretendimit të subjektit se ka deklaruar shtesat e tij, ndërsa mosdeklarimi ka nënkuptuar se gjendja e *cash*-it nuk ka ndryshuar, si dhe nëse do të konsiderohej pretendimi i tij që kursimet e deklaruara në vitin 2003 prej 600.000 lekësh dhe ato të vitit 2004 prej 400.000 lekësh, janë përdorur për krijimin e pasurisë dyqan nr. 1, atëherë si pasuri likuiditet *cash* të akumuluar në vite deri në janar 2017, do të duhej të kishte 400.000 lekë (kursime *cash* të deklaruara në vitin 2014) + 300.000 lekë (kursime *cash* të deklaruara në vitin 2015) + 1.450.000 lekë (kursime *cash* të deklaruara në vitin 2016) = 2.150.000 lekë dhe jo 1.450.000 lekë sa ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në qëndrimin konstant të subjektit lidhur me mënyrën e deklarinimit të likuiditeteve, gjendje *cash*, në banesë në vite, si dhe në deklarinimin periodik të vitit 2009, në të cilin subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë dyqan nr. 1, ndër të tjera, edhe të ardhurat e krijuara në vite të deklaruara më parë, arrin në konkluzionin se më datë 31 dhjetor 2004, ai duhet të kishte pasur gjendje *cash* 400.000 lekë, të krijuar gjatë vitit 2004, mbështetur ky përfundim edhe në konkluzionin e arritur gjatë vlerësimit të pasurisë apartament 76,73 m², se subjekti nuk kishte burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kursimeve 600.000 lekë *cash* në banesë në vitin 2003. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi mundësinë financiare të subjektit për të krijuar kursime *cash* në vlerën 400.000 lekë deri në datën 31 dhjetor 2004. Në analizën financiare u konsideruan: a) të ardhurat e ligjshme nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve të pagave të administruara gjatë hetimit administrativ nga institucionet shtetërore përkatëse, të cilat janë përlogaritur në total në vlerën

1035.071 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Cama të përlllogaritura në vlerën totale 875.709 lekë, duke konsideruar: i) shpenzimet për konsum, bazuar në shpenzimet minimale të jetesës për konsum familjar për vitin 2003 sipas ILDKPKI-së, e cila u referohet shpenzimeve të INSTAT-it për konsum familjar¹⁵ në vlerën 798.786 lekë; ii) shpenzime mobilimi (duke shpërndarë totalin e vlerës së deklaruar nga subjekti, në mënyrë të barabartë gjatë gjithë periudhës së deklarimit, pasi ai nuk ka deklaruar një periudhë konkrete kur ka kryer mobilimin e apartamentit 76,73 m²) në vlerën 76.923 lekë; c) kursime *cash* në banesë të krijuara gjatë vitit 2004 në vlerën 400.000 lekë. Në përfundim të analizës së të dhënave të pasqyruara si më sipër, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhurat e ligjshme krijimin e kursimeve *cash* në banesë, në vlerën 240.638 lekë.

48. Trupi gjykues i Kolegjit, në shqyrtim të pretendimit të subjektit se në kundërshtim me sa ka vendosur Komisioni, të ardhurat e krijuara nga paga e tij dhe e bashkëshortes së tij në vite justifikojnë blerjen e dyqanit nr. 1, vlerësoi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të për të blerë pasurinë dyqan nr. 1 në vlerën 17.870 euro ose 2.332.750 lekë¹⁶, nga data 01.01.2009 deri në datën 08.04.2009, datë në të cilën është provuar kryerja e pagesës, me mandatarë të përcjellë nga shoqëria “{***}” ShPK, i nënshkruar nga administratori i shoqërisë dhe që mban vulën e saj. Trupi gjykues i Kolegjit, në këtë vlerësim nuk ka konsideruar në përlllogaritje kursimet *cash* prej 400.000 lekësh, të cilat si u provua në analizën financiare më sipër, nuk mund të krijoheshin nga subjekti gjatë vitit 2004. Në analizën financiare u konsideruan: a) të ardhurat e ligjshme nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve të administruara gjatë hetimit administrativ nga institucionet shtetërore përkatëse, të cilat janë përlllogaritur në total, në vlerën 774.235 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Cama të përlllogaritura në vlerën totale 421.899 lekë, duke konsideruar: i) shpenzimet për konsum, bazuar në shpenzimet minimale vjetore për konsum familjar sipas INSTAT-it në vlerën 219.666 lekë; ii) shpenzimet për principalin dhe interesat e kredive të marra në Raiffeisen Bank në vlerën 173.861 lekë; iii) pagesën për komisionin e kredisë së marrë në Raiffeisen Bank më datë 25.02.2009, në vlerën 7.218 lekë; iv) shpenzimet e mobilimit (duke shpërndarë totalin e vlerës së deklaruar nga subjekti, në mënyrë të barabartë gjatë gjithë periudhës së deklarimit, pasi ai nuk ka deklaruar një periudhë konkrete kur ka kryer mobilimin e apartamentit 76,73 m²) në vlerën 21.154 lekë; c) ndryshimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën 2.444.333 lekë, duke konsideruar: i) shtimin e pasurisë së paluajtshme dyqan nr. 1 në vlerën 2.332.750 lekë; ii) shtimin e likuiditeteve në bankë, në vlerën 111.583 lekë. Në përfundim të analizës së të dhënave të pasqyruara si më sipër, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhurat e ligjshme blerjen e pasurisë dyqan nr. 1, në vlerën 2.091.997 lekë.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë ambient ish-parkim/garazh, të përshtatur dyqan, me sipërfaqe 45,56 m², në rrugën “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

¹⁵ Shpenzimet për konsum familjar përlllogaritur sipas Komisionit dhe për të cilat subjekti nuk ka paraqitur pretendime në ankim.

¹⁶ Sipas kursit të këmbimit 1 euro = 130.54 lekë, të publikuar në faqen zyrtare.

49. **Për pasurinë e subjektit të rivlerësimit autoveturë, tip “Volkswagen Passat”, vit prodhimi {***}, blerë më datë 01.06.2010 (në vijim: autoveturë “Volkswagen Passat”),** Komisioni ka konkluduar se:
- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij automjeti në vlerën 260.000 lekë;
 - ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve për vitin 2010, në vlerën 357.284 lekë.
50. *Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se dyshimi i shprehur në vendim nga Komisioni, në lidhje me vlerën reale të deklarimit të blerjes apo të shitjes së autoveturës tip “Mercedes Benz” është totalisht i pambështetur në provat e marra në shqyrtim e nuk duhej të ishte ngritur si i tillë, pasi vetë përmbajtja e kontratës së shitjes së autoveturës dhe vlera e tregut të shitblerjes së automjeteve të përdorura në vitin 2009, përcaktojnë qartësisht vlerën e shitjes dhe konkluzioni se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e automjetit të markës “Volkswagen Passat” në qershor 2010, është i gabuar, pasi subjekti ka pasur gjendjen cash prej 1 milion lekësh, të prezumuar pa të drejtë nga Komisioni si të shpenzuar deri në vitin 2005, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka deklaruar në pronësi autoveturë tip “Volkswagen Passat”, vit prodhimi 2002, blerë më datë 01.06.2010, në vlerën 6000 euro, me burim krijimi të ardhurat e krijuara nga paga e tij dhe e bashkëshortes në vite, si dhe shitja e autoveturës tip “Mercedes Benz” në shumën 500.000 lekë. Ndërsa, në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2010, si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga shitja e autoveturës tip “Mercedes Benz”, të ardhurat nga paga, si dhe të ardhura nga qiraja vjetore e pasurisë dyqan nr. 1.*
51. Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se dyshimi i shprehur në vendim nga Komisioni, në lidhje me vlerën reale të deklarimit të blerjes apo të shitjes së autoveturës tip “Mercedes Benz” është totalisht i pambështetur në provat e marra në shqyrtim e nuk duhej të ishte ngritur si i tillë, pasi vetë përmbajtja e kontratës së shitjes së autoveturës dhe vlera e tregut të shitblerjes së automjeteve të përdorura në vitin 2009, përcaktojnë qartësisht vlerën e shitjes, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga verifikimi i deklaratave periodike të pasurisë, subjekti në vitin 2003 ka deklaruar se ka në pronësi autoveturë tip “Mercedes Benz” në vlerën 300.000 lekë, të cilën, siç ka deklaruar në vitin 2009, e ka shitur në vlerën 500.000 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se dyshimet e ngritura nga Komisioni në vendimin nr. 35, datë 12.07.2018, nëse çmimi i kontratës së shitjes së vitit 2009 është i drejtë ose jo, nuk janë të bazuara, megjithëse nuk e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi. Në Kodin Civil nuk ka dispozita që të rregullojnë çmimin e drejtë dhe as dispozita mbi pavlefshmërinë e shitjes, nëse çmimi është i padrejtë. Sipas neneve 92 e 93 të Kodit Civil, veprimi juridik i shitjes me një çmim të padrejtë mund të goditet vetëm për fiktivitet. Duke qenë se nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se kontrata e shitjes është në formën e kërkuar nga ligji dhe nuk është provuar fiktiviteti i saj, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se çmimi i përcaktuar në këtë kontratë nuk është relevant për çështjen.
52. Nga verifikimi i kontratës së shitblerjes së automjetit, me nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 01.06.2010, me palë shitëse A.P. dhe palë blerëse Adriatik Cama, me çmim shitjeje 6000 euro, rezulton se blerësi ka deklaruar që do ta paguajë çmimin me regjistrimin e mjetit. Bashkëlidhur kontratës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor, e cila daton 04.06.2010, datë regjistrimi e konfirmuar edhe nga informacioni i përcjellë në Komision nga

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresë nr. {***} prot., datë 18.05.2018. Bazuar në përcaktimin kontraktor të sipërcituar, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit në plotësim të detyrimit të tij, pagimin e shumës prej 6000 eurosh në favor të shitësit e ka kryer më datë 04.06.2010. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore në Komision, datë 11.07.2018, subjekti i rivlerësimit kundërshton gjetjet e Komisionit se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, duke shpjeguar se në deklaratën e pasurisë së vitit 2010 ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie edhe shumën prej 360.000 lekësh, si të ardhura nga qiraja e dyqanit nr. 1, kurse në deklaratën e rivlerësimit, pjesa e të ardhurave nga qiraja nuk është deklaruar, pasi ai nuk mund të dokumentonte marrëdhënien juridike të qirasë mes tij dhe shtetasit T. G.. Në ankim, subjekti mban qëndrim të ndryshëm duke pretenduar se gjendja *cash* prej 1.000.000 lekësh, prezumuar pa arsye nga Komisioni si e shpenzuar që prej vitit 2005, mjafton matematikisht për të mbuluar si diferencën e pretenduar të mangët në blerjen e dyqanit nr. 1, ashtu edhe shumën që nevojitet për blerjen e autoveturës.

53. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të për të blerë pasurinë autoveturë “Volkswagen Passat”. Në lidhje me pretendimin e subjektit se për blerjen e kësaj pasurie ka përdorur paratë *cash* që ka pasur në banesë që në vitin 2004, trupi gjykues vlerëson se ashtu siç ka konkluduar nga analizat financiare më sipër¹⁷, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar kursimet *cash* në vitet 2003 dhe 2004. Në lidhje me të ardhurat prej 360.000 lekësh, të përfituara nga dhënia me qira e pasurisë dyqan nr. 1, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar si burim krijimi për autoveturën “Volkswagen Passat” në deklaratën periodike të vitit 2010, trupi gjykues i Kolegjit, duke konstatuar se bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues që të vërtetojë ekzistencën e marrëdhënies së qirasë, përfitimin e të ardhurave të deklaruara nga qiraja e dyqanit nr. 1, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore që burojnë nga kjo marrëdhënie, vlerëson se në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 3, pika 19 e 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të ardhurat e përfituara nga subjekti nga dhënia me qira e dyqanit nr. 1 për vitin 2010, nuk konsiderohen si të ardhura të ligjshme dhe, për këtë arsye, nuk do të përfshihen në analizën financiare për këtë pasuri.

Trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si burim krijimi të autoveturës “Volkswagen Passat”, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar edhe të ardhurat e krijuara nga shitja e autoveturës tip “Mercedes Benz” në shumën 500.000 lekë. Të njëjtin burim, subjekti e ka cituar edhe në deklaratën e vitit 2010, por pa cituar vlerën e të ardhurave të përdorura. Nga verifikimi i kontratës së shitblerjes së pasurisë të luajtshme autoveturë “Mercedes Benz”, tipi 201, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.12.2009, me palë shitëse Adriatik Cama dhe palë blerëse H. K. rezulton se çmimi i shitjes është 500.000 lekë. Në deklaratën e vitit 2009, subjekti ka deklaruar brenda së njëjtës rubrikë, si pakësim pasurie shitjen e autoveturës “Mercedes Benz” në vlerën 500.000 lekë dhe shtim pasurie të ardhurat nga shitja e kësaj autoveture në vlerën 400.000 lekë. Bazuar në këtë situatë faktike të provuar si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se si burim krijimi të pasurisë autoveturë “Volkswagen Passat”, subjekti ka përdorur shumën prej 400.000 lekësh nga shitja e autoveturës “Mercedes Benz” dhe jo 500.000 lekë, sa ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

¹⁷ Shih paragrafët 42 dhe 47 të këtij vendimi.

54. Në analizën e vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur, për të blerë pasurinë autoveturë “Volkswagen Passat”, në vlerën 6.000 euro ose 820.080 lekë¹⁸, nga data 01.01.2010 deri më datë 04.06.2010, u konsideruan: a) të ardhurat e ligjshme nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve të administruara gjatë hetimit administrativ nga institucionet shtetërore përkatëse, si dhe të ardhurat nga shitja e autoveturës tip “Mercedes Benz”, të cilat janë përlllogaritur në total, në vlerën 1.105.253 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Cama, të përlllogaritura në vlerën totale 424.480 lekë, duke konsideruar: i) shpenzimet për konsum, bazuar në shpenzimet minimale vjetore për konsum familjar të INSTAT-it, në vlerën 332.828 lekë; ii) interesat e paguara për kreditë e marra në Raiffeisen Bank deri më datë 04.06.2010, në vlerën 59.601 lekë; iii) shpenzime mobilimi (duke shpërndarë totalin e vlerës së deklaruar nga subjekti, në mënyrë të barabartë gjatë gjithë periudhës së deklarimit, pasi ai nuk ka deklaruar një periudhë konkrete kur ka kryer mobilimin e apartamentit 76,73 m²) në vlerën 32.051 lekë; c) ndryshimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën 1.046.513 lekë, duke konsideruar: i) shtimin e pasurisë së luajtshme autoveturë në vlerën 820.080 lekë; ii) shtesë në likuiditetet në bankë në vlerën 122.025 lekë, për periudhën në analizë; iii) shlyerje detyrimi, principali për kredinë në Raiffeisen Bank, në vlerën 104.408 lekë. Në përfundim të analizës së të dhënave të pasqyruara si më sipër, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhurat e ligjshme blerjen e automjetit në vlerën 365.740 lekë.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë autoveturë tip “Volkswagen Passat”, vit prodhimi 2002, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë pretendimi i tij është i pabazuar.

55. **Për depozitën bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit A.C., e krijuar në maj 2008, në vlerën 4000 euro, Banka “Intesa San Paolo”, Komisioni ka konkluduar se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e depozitës bankare në maj të vitit 2008, në emër të bashkëshortes së tij, në vlerën 375.000 lekë.**

56. *Lidhur me pretendimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, se konkluzioni i Komisionit se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e depozitës bankare në vitin 2008, në emër të bashkëshortes së tij, është i gabuar, pasi subjekti nga gjendja cash prej 1 milion lekësh, të prezumuar pa të drejtë nga Komisioni si të shpenzuar deri në vitin 2005, një pjesë të tyre, në shumën 4000 euro, i ka vendosur në depozitë të përkohshme, e domosdoshme kjo për marrjen e një vize “Shengen”, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Intesa San Paolo Bank me shkresë nr. {***} prot., datë 23.01.2018, A.C., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka krijuar një depozitë bankare, duke depozituar cash shumën 4.000 euro, më datë 21.05.2008. Kjo depozitë është mbyllur më datë 28.08.2008.*

Në lidhje me pretendimin e subjektit në ankim, pretendim që rezulton se e ka shprehur edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit dhe në seancë dëgjimore në Komision, datë 11.07.2018, se krijimi i kësaj depozite është kryer me burime financiare të ligjshme, pasi në vitin 2008 ai kishte gjendje cash në banesë shumën prej 1.000.000 lekësh, të cilat i kishte deklaruar më parë në deklaratat e vitit 2003 e 2004 dhe nga kjo shumë, 4.000 euro i ka vendosur në depozitë të përkohshme në Bankën Intesa San Paolo, trupi gjykues i Kolegjit i qëndron konkluzionit të nxjerrë nga analiza financiare e kryer prej tij në paragrafët 42 dhe 47 të këtij vendimi, se subjekti i

¹⁸ Konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit 1 euro = 136,68 lekë, sipas të dhënave në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë për muajin qershor 2010.

rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar kursimet *cash* në vitet 2003 dhe 2004.

57. Mbështetur në faktet e provuara si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit analizoi mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur, për të krijuar depozitën bankare në vlerën 4000 euro ose 488.520 lekë¹⁹, për periudhën 1 janar 2008 deri në 21.05.2008. Në analizën financiare u konsideruan: a) të ardhurat e ligjshme nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve të pagave të administruara gjatë hetimit administrativ nga institucionet shtetërore përkatëse, në vlerën totale 497.573 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Cama, të përlloraritura në vlerën totale 398.536 lekë, duke konsideruar: i) shpenzimet për konsum, bazuar në shpenzimet minimale vjetore për konsum familjar të INSTAT-it në vlerën 332.827 lekë; ii) interesat e paguar për kreditë e marra në Raiffeisen Bank në vlerën 12.876 lekë; iii) shpenzimet e udhëtimit jashtë kufijve në vlerën 25.269 lekë; iv) shpenzimet e mobilimit (duke shpërndarë totalin e vlerës së deklaruar nga subjekti, në mënyrë të barabartë gjatë gjithë periudhës së deklaramit, pasi ai nuk ka deklaruar një periudhë konkrete kur ka kryer mobilimin e apartamentit 76,73 m²) në vlerën 27.564 lekë; c) shlyerjen e detyrimit, principali për kredinë në Raiffeisen Bank, në vlerën -29.312 lekë; ç) ndryshimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën 517.050 lekë, duke konsideruar: i) krijimin e depozitës në vlerën 488.520 lekë; ii) shtesën në likuiditete në bankë, në vlerën -781 lekë. Në përfundim të analizës së të dhënave të pasqyruara si më sipër, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhurat e ligjshme krijimin e depozitës më datë 21.05.2008, në vlerën 418.013 lekë.

Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e depozitës 4.000 euro nga bashkëshortja e tij në bankën “Intesa San Paolo”, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë pretendimi i tij është i pabazuar.

58. Për sa u përket konkluzioneve të Komisionit në vendimin nr. 35, datë 12.07.2018, se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendjen e likuiditeteve në bankën “Credins”, në vlerën prej 1039 eurosh, në deklaratën e pasurisë së vitit 2009; subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, nuk kanë deklaruar gjendjet e llogarive bankare në fund të viteve përkatëse; subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë pranë Komisionit lidhur me financimin e llogarive bankare të tij, si edhe nuk i ka deklaruar këto të ardhura të kredituara në llogaritë e tij dhe të bashkëshortes së tij ndër vite, si dhe burimin e krijimit të tyre, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shkaqe ankimi dhe, për këtë, arsye nuk i mori në shqyrtim, duke i konsideruar të pranuar nga subjekti i rivlerësimit.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit, lidhur me situatën faktike dhe ligjin material për kriterin e kontrollit të figurës

59. Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se vendimi i Komisionit nr. 35, datë 12.07.2018, në lidhje me kontrollin e figurës, është i njëanshëm, pasi refuzimi për t'u pyetur si dëshmitar cilido subjekt i aluduar si dhënësi i një mite ndaj subjektit të rivlerësimit, e ka zhveshur atë nga mbrojtja efektive, në kundërshtim të plotë me parimet e procesit të rregullt ligjor, të shprehura edhe në vendimet e GjEDNj-së, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni, me

¹⁹ Konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit, datë 21.05.2008, 1 euro = 122,13 lekë, sipas të dhënave në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë për muajin qershor 2010.

vendimin nr. 2, datë 19.06.2018, ka vendosur përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, ndërsa më datë 21.06.2018, subjektit i janë bërë të njohura rezultatet e hetimit administrativ dhe i është njoftuar kalimi i barrës së provës, bazuar në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe i janë bërë të ditura të drejtat e tij, për t'u njohur me materialet e dosjes, për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse, si dhe për të paraqitur shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, brenda një afati 12-ditor, nga data e marrjes së njoftimit. Në rezultatet e hetimit administrativ, në lidhje me kontrollin e figurës, Komisioni është shprehur se vlerëson që subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka bërë një hetim të thelluar administrativ në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nga ku, sipas informacionit të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese ka evidentuar se subjekti i rivlerësimit është përfshirë në korrupsion pasiv së bashku me një prokuror tjetër, prandaj në zbatim të nenit Dh të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Unë nuk jam përfshirë në korrupsion pasiv, as në trajtën e pagesave, as të shkëmbimit të favoreve apo dhuratave me personin e hetuar Sh. K., apo familjarët e tij dhe as për ndonjë rast tjetër. [...] Pavarësisht faktit se vlerësimi i kontrollit të figurës sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, fillon nga data 01.01.2012 dhe kontrolli i figurës së subjektit është bërë në tejkallim të afateve të përcaktuara në ligj, unë kërkoj që të merret si provë nga ana juaj, dëshmia e personave të përfshirë në raportin e kontrollit të figurës, si vetë subjekti i procedimit penal dhe familjarë të tij.*

Komisioni, me vendimin e datës 05.07.2018 ka vendosur të refuzojë kërkesën e subjektit për thirrjen e dëshmitarëve, me arsyetimin se kërkesa për thirrjen e dëshmitarëve nuk përmbushte kushtet e një kërkesë të mirëfilltë procedurale dhe se bazuar në pikën 6, shkronja "b" e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se kjo kërkesë është bërë me qëllim zvarritjen e gjykimit dhe se pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit, pasi rezultatet e hetimit bazohen mbi dokumente të marra nga burime të njohura dhe në prova të besueshme. Ky vendim i është njoftuar rregullisht subjektit të rivlerësimit, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.07.2018, nëpërmjet shërbimit postar. Në ankim, subjekti pretendon se kërkesa e tij për t'u pyetur cילו subjekt i aluduar si dhënës i një mite ndaj tij, u refuzua nga Komisioni pa asnjë shkak ligjor, duke përbërë një ves sa formal, aq edhe përmbajtësor të procesit e provë të njëanshmërisë gjyquese, në kundërshtim të plotë me parimet e procesit të rregullt ligjor, të shprehura edhe në vendimet e GjEDNj-së.

60. Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se në procesin e rivlerësimit, bazuar në nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës i përket subjektit të rivlerësimit. Procesi i rivlerësimit është i natyrës argumentuese, çka nënkupton se i përket subjektit të rivlerësimit të parashtrijë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështet pretendimet e tij, për të kundërtën e rezultateve të hetimit. Në këtë kuptim, është detyrë e subjektit të shpjegojë arsyet pse kërkon të thirren në cilësinë e dëshmitarit, personat e cituar prej tij. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të thirren si dëshmitarë, personat e përmendur në raportin e DSIK-së, shtetasi SH. K. dhe familjarë të tij, për të cilët Komisioni beson se kanë kryer korrupsion aktiv ndaj subjektit, për të përfutur pushimin e procedimit penal ndaj shtetasit Sh. K. Komisioni e ka shqyrtuar kërkesën e subjektit dhe bazuar në nenin 49, pikat 6 dhe 9 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të arsyetuar, e ka rrëzuar atë. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se neni 6 i KEDNj-së nuk garanton qartazi të drejtën për të thirrur dëshmitarë dhe pranueshmëria e dëshmimeve,

në parim, është kompetencë e së drejtës së brendshme²⁰. Në jurisprudencën e saj, në çështjen Wierzbicki k. Polonisë, 2002, GjEDNj është shprehur: “[...] Gjykata është e kënaqur që gjykatat e brendshme shqyrtuan kërkesat e aplikantit për të thirrur dëshmitarë dhe dhanë arsye të hollësishme për refuzimet e tyre, të cilat, sipas Gjykatës nuk ishin të ndotura nga arbitrariteti. Për këto arsye, refuzimi për të marrë provat e propozuara nga kërkuesi nuk përbën një kufizim joproporcional, të aftësisë së tij për të paraqitur argumente në mbështetje të rastit të tij, gjatë gjykimit. Sa më sipër, nuk ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës.” Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 38/2010 është shprehur: “Nëse gjykatat e zakonshme vërejnë se dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, ato mund ta refuzojnë kërkesën për marrjen në pyetje të dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë. Kjo nuk bëhet për të siguruar vetëm respektimin e barazisë së armëve, por dhe të parimit të kontradiktoritetit të gjykimit ose të shqyrtimit të provave.”

Trupi gjykues i Kolegjit, nën dritën e zbatueshmërisë së parimeve të cituara në jurisprudencat e mësipërme, në rastin konkret vlerëson se Komisioni ka refuzuar në mënyrë të arsyetuar marrjen e provës me dëshmitarë. Për shkak të rrethanave në të cilat pretendohet se ndodhen këta dëshmitarë (bashkëfajësia e dyshuar në dhënie dhe marrje mite), dëshmia e tyre nuk ka asnjë relevancë në marrjen e vendimit. Për këto arsye, nuk ka shkelje të parimeve të procesit të rregullt, për sa i përket refuzimit të marrjes së provës me dëshmitarë.

Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

61. *Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se akti i vetëm i renditur si provë në vlerësimin e kontrollit të figurës së tij, daton në vitin 2005 dhe, edhe vetëm për këtë fakt, ky akt nuk duhet të përbënte relevancë shqyrtimi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se DSIK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.06.2018, ka përcjellë në Komision raportin e përditësuar të Grupit të Punës për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Adriatik Cama, me nr. {***} prot., datë 28.05.2018, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 07.06.2018. Në këtë raport, grupi i punës i DSIK-së shprehet se sipas informacionit të ardhur nga autoritetet verifikuese, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama, në vitin 2005, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, së bashku me prokurorin e çështjes kanë marrë një shumë të konsiderueshme parash nga familjarët e shtetasit Sh. K., i ndaluar për kontrabandë, për pushimin e çështjes penale në ngarkim të tij. Grupi i punës vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në një situatë që evidenton forma të shfaqjes së korrupsionit pasiv, të kryerjes së veprimeve/dhënies së urdhrave arbitrarë gjatë ushtrimit të detyrës, me qëllim mitëmarrje prej personit të ndaluar/nën hetim, për favorizim/pushim të çështjes në ngarkim të tij, në papajtueshmëri të plotë me detyrën. Sipas grupit të punës të DSIK-së, kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që përfshin veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, ku përfshihen “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”. Më tej, grupi i punës ka vlerësuar se kjo marrëdhënie korruptive ndërmjet dy prokurorëve, veçmas asaj të qenit kolegë dhe për shkak të detyrës, evidenton rrethanat e konstatimit të faktit se ekzistojnë kontakte të papërshtatshme sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Edhe pse të dhënat që disponohen për subjektin e rivlerësimit datojnë para periudhës së parashikuar për kontrollin e figurës, grupi i punës vlerëson se distanca kohore përbën rrethanë lehtësuese, por jo domosdoshmërisht përjashtuese dhe, në përfundim, gjykon se veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit në bashkëpunim cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimin e shkronjës “ç” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Adriatik I. Cama vlerësohet si individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale. Grupi i punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet*

²⁰ *Shih arsyetimin e GjEDNj-së në çështjen Dombo Beheer k. Holandës, 1993.*

verifikuese, konfirmon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

62. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se ky akt i vetëm, i renditur si provë në vlerësimin e kontrollit të figurës për të, duke qenë se daton në vitin 2005, jashtë periudhës së përcaktuar nga Kushtetuta për kontrollin e figurës, nuk duhet të përbënte relevancë shqyrtimi.

Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në situatën faktike si më sipër dhe në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, arsyeton se ligji nr. 84/2016, në nenin 34 të tij parashikon se kontrolli i figurës bëhet sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Pika 2 e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës përcakton se subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit. Deklarata e figurës, shtojca nr. 3 e ligjit nr. 84/2016 në pjesën 2 “Të dhëna për vendin e banimit”, në pjesën 4 “Të dhëna për punësimin”, si dhe në pjesën 5 “Të dhëna për sigurinë”, në shkronjat “a”-“f” dhe “h”, kërkon që subjekti i rivlerësimit të japë të dhëna duke filluar nga data 1.1.2012. Ndërsa në shkronjën “g”²¹ të pjesës 5 kërkohen të dhëna për dhjetë vitet e fundit, në ndryshim nga afati i përcaktuar në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Ligji nr. 84/2016, i cili detajon procedurën e kontrollit të figurës, të kryer nga grupi i punës i DSIK-së dhe Komisioni, në asnjë rast nuk e kufizon kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit vetëm “për periudhën nga 1 janari 2012 e deri në ditën e deklaramit” (janar 2017). Bazuar në nenin 39, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 84/2016, kontrolli për figurën bazohet në dy elemente që plotësojnë njëra-tjetrën: konstatimin e ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, çka përbën elementin përmbajtësor të këtij kontrolli dhe konstatimin e plotësisë dhe besueshmërisë së deklaramit, çka përbën elementin formal të këtij kontrolli. Mjaftueshmëria dhe vërtetësia e deklaramit kontrollohen për periudhën e deklaruar në Aneksin e Kushtetutës, ndërsa për sa i përket aspektit përmbajtësor të kontrollit të figurës, afati i tij mund të shtrihet edhe përpara datës 1 janar 2012. Lidhja e vërtetësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit me një afat kohor, në mënyrë të posaçme lidhet me vetë faktet që kërkohen të deklarohen, të cilat kërkojnë kujtesën dhe perceptimin subjektiv të subjektit të rivlerësimit. Ligji nr. 84/2016, në nenin 38, pika 5, shkronja “d” përcakton si rrethanë lehtësuese që merret parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, kur: “d) kontaktet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë pesë vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontakteve dhe/ose me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni”. Ky përcaktim e shtrin kontrollin përmbajtësor të figurës së subjektit në verifikimin e kontakteve edhe para datës 1 janar 2012²², por kjo do të duhet të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, e cila vlerësohet më pas, sipas kushteve të përcaktuara më tej në këtë dispozitë. Kjo mënyrë e interpretimit të normës kushtetuese vjen në harmoni edhe me vetë qëllimin e procesit të rivlerësimit, të shprehur në nenin 179/b të Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, i cili është garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

DSIK-ja në raportin e saj, në përputhje me nenin 38, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e ka cilësuar distancën kohore si një rrethanë lehtësuese, por duke vlerësuar rëndësinë e veprimtari dhe cenimin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, e ka vlerësuar atë si një veprimtari të paligjshme, duke konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. Sa më

²¹ Të dhëna për refuzimin e hyrjes në ndonjë shtet të BE/NATO.

²² Ligji nr. 84/2016 ka hyrë në fuqi në datë 08.10.2016

sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni, me të drejtë, e ka shtrirë vlerësimin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit edhe përpara datës 1 janar 2012.

Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se fakti i datuar në vitin 2005 nuk duhet të përbënte relevancë shqyrtimi, është i pabazuar.

63. *Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni nuk ka kryer aspak hetim dhe aq më tepër një hetim të plotë e të gjithanshëm, për sa i takon vlerësimin të figurës së subjektit të rivlerësimit, duke marrë të mirëqenë një informacion të rremë të DSIK-së. Atribuimi i një fakti korruptiv, pa përcaktime konkrete të personit korruptues, përbën shkelje të të drejtave themelore e atyre të posaçme të këtij procesi për subjektin, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se veprimet procedurale dhe hetimore të kryera nga Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit Adriatik Cama, renditen si në vijim:*

Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 31.01.2018, i ka kërkuar DSIK-së fillimin e procedurave për deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” për subjektin e rivlerësimit, të dërguar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Adriatik Cama”. Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” (më poshtë KDZH) pranë DSIK-së, me vendimin nr. {***}, datë 13.04.2018, vendosi të deklasifikojë pjesërisht raportin nr. {***} prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit Adriatik Cama. Me shkresën nr. {***} prot., datë 16.04.2018, DSIK-ja dërgon në Komision raportin e mësipërm për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar pjesërisht. Me shkresën nr. {***} prot., datë 16.05.2018, Komisioni i kërkon DSIK-së përfshirjen e informacioneve shtesë të dërguara nga ShISH-i në raportin e kontrollit të figurës, si dhe deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” për subjektin e rivlerësimit. DSIK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.06.2018, përcjell raportin nr. {***} prot., datë 28.05.2018, për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Adriatik Cama, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 07.06.2018, të KDZH-së. Grupi i punës pranë DSIK-së, bazuar në shkronjën “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ka raportuar se subjekti i rivlerësimit vlerësohet si individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale dhe konfirmon konstatimin fillestar të dhënë për të për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës. Për të krijuar bindjen mbi vërtetësinë e informacioneve të marra nga raporti i grupit të punës së DSIK-së, Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 14.05.2018, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për të marrë dosjen e procedimit penal, të cituar në raportin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, duke kërkuar prej këtij institucioni edhe opinion/interpretim ligjor në lidhje me vendimmarrjen e prokurorëve, të cilët kanë ndjekur çështjen. Prokuroria e Përgjithshme pas verifikimeve të nevojshme mbi dosjen e marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lushnje dhe studimit të akteve të saj, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.06.2018, dërgon informacion të detajuar lidhur me çështjen, duke konstatuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lushnje, në datën 15.03.2005, ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, për veprën penale “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit SH. K. Fillimisht, për hetimin e këtij procedimi penal është ngarkuar prokurorja R.H.. Nga ana e prokurores, pasi është marrë vendimi për regjistrimin e procedimit penal, është përpiluar dhe

dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Lushnje, në datën 15.03.2005, kërkesa për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit të arrestuar Sh. K., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Në datën 17.03.2005, subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama, në atë periudhë me cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, bazuar në nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale ka nxjerrë vendimin për zëvendësimin e prokurores R.H. me prokurorin GJ.T., duke ngarkuar këtë të fundit për ndjekjen e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2005. Në vendimin e datës 17.03.2005 për zëvendësimin e prokurores R.H. me prokurorin GJ.T., drejtuesi i Prokurorisë Adriatik Cama arsyeton se ekzistojnë arsye të parashikuara në nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale, për të cilat prokurorja R.H. duhet zëvendësuar, por pa i specifikuar cilat janë ato. Prokuroria e Përgjithshme konstaton se vendimi i drejtuesit të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lushnje, për zëvendësimin e prokurores R.H., nuk është i argumentuar. Pavarësisht se në vendim, drejtuesi përmend bazën ligjore (nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale), ai nuk i referohet asnjërit prej shkaqeve të parashikuara nga ky nen për të legjitimuar zëvendësimin e prokurores. Gjithashtu, nga aktet e dosjes, nuk rezultojnë shkaqe për përjashtimin apo zëvendësimin e prokurores së çështjes, sipas kërkesave të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale. Me vendimin datë 02.06.2005, prokurori i çështjes GJ.T., bazuar në nenin 328/1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2005, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Ky vendim është firmosur edhe nga drejtuesi i Prokurorisë së Shkallës së Parë, Lushnje. Rezulton se ky vendim pushimi është shfuqizuar me vendimin datë 05.10.2005 të Drejtorit të Drejtorisë së Personelit dhe Inspektimit pranë Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, prokuror K. B.. Lidhur me vendimmarrjen e kryer nga ana e prokurorëve për zgjidhjen përfundimtare të këtij procedimi penal, konstatohet se vendimi i pushimit të procedimit penal, datë 02.06.2005, marrë nga prokurori GJ.T. dhe miratuar nga drejtuesi i Prokurorisë Adriatik Cama, ashtu sikurse arsyetohet në vendimin e shfuqizimit të këtij vendimi nga Prokuroria e Përgjithshme, është i pambështetur në ligj e prova. Vendimi është marrë në kundërshtim me kërkesat e nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale që ka qenë në fuqi në kohën që hetohej procedimi penal, pa u kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore. Informacionit të sipërpërmendur, Prokuroria e Përgjithshme i ka bashkëlidhur dosjen e procedimit penal nr. {***}/2005 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Lushnje.

Në seancën dëgjimore në Komision datë 10.07.2018, subjekti deklaroi se i kishte marrë të gjitha dokumentet, pjesë përbërëse e dosjes së tij të rivlerësimit. Gjatë kësaj seance, subjekti u ka qëndruar shpjegimeve të dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, por megjithëse ka shtuar se atij i kishin ardhur sinjalizime se prokurorja R.H. po e përdorte kërkesën për masën e sigurisë arrest me burg për shtetasin Sh. K. si presion ndaj këtij subjekti të procedimit penal, ka mbetur përsëri në nivelin e deklaratave, duke mos paraqitur asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën e gjetjeve të hetimit, sidomos për veprime të mundshme të tij si drejtues prokurorie, për verifikimin e sinjalizimeve të pretenduara ndaj prokurores R.H.. Të njëjtat shpjegime, subjekti i ka paraqitur

edhe në parashtrimet me shkrim të paraqitura 5 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore, por duke shtuar se ashpërsia e masës së kërkuar nga prokurorja R.H. pas arrestit në flagrancë të shtetasit SH. K., ishte tërësisht e pajustificuar në kriteret ligjore dhe praktika gjyqësore, prandaj ai në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë kërkoi zëvendësimin e saj.

64. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të situatës faktike si më sipër dhe në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se ligji nr. 84/2016 në nenin 36, pika 1 përcakton se institucionet e rivlerësimit në bashkëpunim me DSIK-në janë autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës. Në vendimin nr. 2/2017, Gjykata Kushtetuese është shprehur: “Në lidhje me kontrollin e figurës, DSIK-ja është organi që ka mundësinë praktike për të bërë verifikime të thella edhe jashtë vendit, në bazë të bashkëpunimit me organe të tjera homologe, çka krijon mundësinë që të bëhet një hetim i plotë dhe i gjithanshëm në lidhje me të dhënat që deklarohen nga subjektet. Grupi i punës, në përbërje të të cilit ka edhe përfaqësues nga DSIK-ja, ka të drejtë të bëjë kërkime dhe propozime meqenëse përfaqëson institucione të specializuara. Nga ana tjetër, organet e rivlerësimit nuk janë të detyruara t’i marrin apriori në konsideratë gjetjet e grupit të punës, si dhe kanë akses të drejtpërdrejtë në të gjitha bazat e të dhënave qeveritare”.

Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni, vlerësimin për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, nuk e ka mbështetur vetëm në gjetjet e raportit të DSIK-së, por e ka thelluar hetimin administrativ dhe i ka vërtetuar/provuar këto gjetje edhe me konkluzionet e nxjerra nga verifikimet dhe konstatimet e informacionit/opinionit ligjor të Prokurorisë së Përgjithshme, në lidhje me vendimmarrjen e prokurorëve të cilët kanë ndjekur procedimin penal nr. {***/2005, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Lushnje. Komisioni, vendimmarrjen e tij e ka bazuar në dokumentacionin e administruar, të klasifikuar dhe të deklasifikuar, në hetimet e kryera dhe në dokumentacionin e prodhuar nga ky hetim administrativ, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë provë për të arritur të provojë të kundërtën. Subjektit i është garantuar dhe i është dhënë mundësia që t’i jepte Komisionit një përshkrim të detajuar të ngjarjes që përmbante rezultati i hetimit administrativ. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore, subjekti kishte mundësinë për të sfiduar besueshmërinë e raportit të DSIK-së, por edhe të informacionit të Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me mosarsyetimin e vendimit për zëvendësimin e prokurorës së çështjes, si dhe në lidhje me pranimin dhe nënshkrimin e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {***/2005, datë 02.06.2005, të prokurorit GJ.T., megjithëse ai ka qenë në kundërshtim me nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale, që ka qenë në fuqi në kohën që po hetohej procedimi penal, pa u kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore. Madje, në shpjegimet e tij në seancë dëgjimore në Komision, vetë subjekti ka pranuar që hetimi i çështjes nga prokurori GJ.T. ka qenë i paplotë. Gjithashtu, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ai ka mohuar që të jetë përfshirë në korrupsion pasiv me personin e hetuar Sh. K., apo me familjarët e tij, dhe njëkohësisht ka kërkuar që të merret si provë nga Komisioni, dëshmia e personave të përfshirë në raportin e kontrollit të figurës, si vetë subjekti i procedimit penal dhe familjarët e tij. Pra, rezulton se subjekti, në kundërshtim me sa pretendon, është vënë në dijeni të faktit korruptiv të pretenduar (procedimi penal ndaj shtetasit SH. K.) dhe personit korruptues SH. K. (subjekt i procedimit penal). Për sa u përket familjarëve të shtetasit Sh. K., të dyshuar si

mitëdhënës ndaj subjektit të rivlerësimit, është fakt që emrat e tyre nuk janë përmendur në aktet e fashikullit gjyqësor, por subjektit i është bërë i ditur personi kryesor korruptues, i pretenduar si i lidhur drejtpërdrejt me veprimet apo mosveprimet e subjektit të rivlerësimit si drejtues i Prokurorisë së Shkallës së Parë, Lushnje.

Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

65. *Lidhur me pretendimin e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit që në konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm për detyrën, nuk është zbatuar asnjë standard i nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, pasi atij nuk i atribuohet asnjë kontakt i çfarëdolloji me subjekte që janë përfshirë apo dyshohen si pjesëtarë të strukturave të organizuara kriminale, madje DSIK-ja përcakton që formulari i plotësuar nga subjekti është tërësisht i saktë dhe në përputhje me ligjin, ndërkohë që Komisioni mbërrin në të kundërtën përkatëse, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në raportin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit të datës 02.11.2017, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 13.04.2018, të KZhD-së, grupi i punës i DSIK-së ka konstatuar se: *Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016*, por bazuar në shkronjën “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016 ka raportuar se subjekti i rivlerësimit vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale dhe, për këtë arsye, konstaton papërshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës. Ndërsa, në raportin e përditësuar për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Adriatik Cama, me nr. {***} prot., datë 28.05.2018, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 07.06.2018, grupi i punës i DSIK-së ka sqaruar rrethanat për të cilat ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, të cilat datojnë në vitin 2005. Komisioni, bazuar në rrethanat e konstatuara nga grupi i punës i DSIK-së, në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, në vendimin nr. 35, datë 12.07.2018, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.*
66. *Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se fillimi i procedurës për kontrollin e figurës, bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 84/2016, referon fillimisht mbi verifikimin e afatit të dorëzimit të deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të këtij ligji, dhe më tej mbi verifikimin e saktësisë së saj në përputhje me standardet e plotësimit, sipas pikave 6 dhe 7 të nenit 38 të këtij ligji. Deklarata për kontrollin e figurës, bazuar në pikën 2 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, plotësohet për periudhën nga 1 janari 2012 e deri në ditën e deklaramit, duke sanksionuar detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të plotësuar deklaratën me saktësi dhe vërtetësi, vetëm për këtë periudhë. Rrethanat e konstatuara nga grupi i punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit i përkasin vitit 2005, një periudhe më të hershme sesa afati i përcaktuar në dispozitën kushtetuese. Neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 parashikon dhënien e masës disiplinore në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të këtij ligji.*
- Neni 39 parashikon procedurën e kryer nga DSIK-ja për kontrollin e figurës, si dhe çfarë përcakton raportin i përgatitur nga grupi i punës së DSIK-së. Sipas pikës 2 të nenit 39, ky raport duhet të*

përcaktojë nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi; nëse ka informacion në deklarimin e tij ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës. Duke qenë se ngjarja për të cilën referon raporti i DSIK-së, ka ndodhur në vitin 2005, vetë raporti i grupit të punës së DSIK-së ka konkluduar: “Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016”.

Standardet e kontrollit të figurës përcaktohen nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është i plotë dhe i besueshëm, përcaktohen në pikën 6 të këtij neni dhe janë kur:

“a) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme;

b) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt, i cili përforcohet ose konsiderohet i besueshëm nga informacione të shërbimeve të fshehta dhe të besueshme;

c) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që konstatohet nga informacioni përkatës i besueshëm dhe nga prova të tjera; në rast se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të tjera që janë renditur ose konstatuar sipas këtij paragrafi; në rast se ka prova të tjera për një përfitim, veprim ose pasojë nga kontakti që krijon një dyshim të arsyeshëm se informacioni i marrë është shpjegimi i vetëm i mundshëm.”

Komisioni në vendimin nr. 35, datë 12.07.2018, në analizën dhe arsyetimin mbi kriterin e kontrollit të figurës, nuk rendit asnjë nga rrethanat e mësipërme të nenit 38, pika 6, megjithëse ka arritur më pas në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në faktin se rrethanat e konstatuara nga grupi i punës së DSIK-së dhe Komisioni i përkasin një periudhe tej afatit kushtetues, “nga 1 janari 2012 e deri në ditën e deklaramit”, si dhe bazuar në analizën e situatës ligjore si më sipër, arrin në përfundimin që konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, nuk është i bazuar në prova e në ligj dhe, për rrjedhojë, nuk është i drejtë.

67. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se konstatimi përfundimtar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësimit të deklaratës së figurës. Në raportin e përditësuar të DSIK-së, me nr. {***} prot., datë 28.05.2018, citohet se veprimtaria e paligjshme e korrupsionit pasiv të prokurorit i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që përfshin veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, ku përfshihen “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni” dhe se kjo marrëdhënie evidenton rrethanat e konstatimit të faktit se ekzistojnë kontakte të papërshtatshme sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, grupi i punës, bazuar në shkronjën “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016 ka konkluduar, duke e vlerësuar subjektin si individ të mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale. Nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, DSIK-ja konfirmon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se raporti i DSIK-së pasqyron rrethana të cilat lidhen drejtpërdrejt me veprimet e mosveprimet e dyshuara të vetë subjektit të rivlerësimit. Qëllimi dhe fryma e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës, kërkon që procesi i rivlerësimit të identifikojë gjyqtarët e prokurorët, të cilët kanë integritet të cenuar, duke i përjashtuar ata nga sistemi i drejtësisë. Ligji, duke urdhëruar verifikimin, nëse subjektet kanë kontakte të papërshtatshme, nuk mund të përjashtojë verifikimin e figurës së vetë subjektit, nëse ka dyshime të bazuara se ai është përfshirë në krimin e organizuar, sipas pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konkretisht në korrupsion pasiv. Korrupsioni në sistemin e drejtësisë lidhet me ndikimet e padrejta që prekin pavarësinë e drejtësisë si sistem dhe/ose pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve si individë. Rëndësia e integritetit të figurës së gjyqtarit apo prokurorit, është theksuar në një numër aktesh ndërkombëtare, si: “Parimet themelore të pavarësisë së sistemit të drejtësisë” i OKB-së, 1985, “Parimet e Bangalor-it për sjelljen në sistemin gjyqësor”, 2002, “Udhëzuesi evropian për etikën dhe sjelljen e prokurorëve” i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, 2005 etj.

68. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se atij nuk i atribuohet asnjë kontakt me persona të kimit të organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit, në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit konstaton se në vendimin nr. 35, datë 12.07.2018, Komisioni nuk i është referuar, në asnjë moment, nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Referimin te ky nen e gjejmë vetëm te rezultatet e hetimit administrativ, në të cilin Komisioni është shprehur se “referuar informacionit të DSIK-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme, sipas nenit 38, pika 4, shkronjat “c” dhe “d”, duke shkëmbyer favore apo dhurata (pushimi i akuzave penale ndaj z. Sh. K.) me persona (familjarët e z. Sh. K.) të përfshirë në krimin e organizuar (dokumentuar si shkelje e ligjit, shih pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, si dhe referuar nenit 319 “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”). Për të njëjtat arsye, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas përcaktimeve të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.”

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, përcaktohen në pikën 4 të nenit 38, dhe janë kur: “a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar, ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.”

Pika 3 e nenit 15 të ligjit nr. 84/2016 parashikon se, që një person të konsiderohet “i përfshirë në krimin e organizuar”, duhet të jetë dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të

Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar (në vijim ligji nr. 10192/2009, i ndryshuar). Trupi gjyqësor i Kolegjit konstaton se ndaj shtetasit Sh. K., të cilit grupi i punës së DSIK-së dhe Komisioni i kanë dhënë cilësinë e personit të përfshirë në krimin e organizuar, është regjistruar më datë 15.03.2005 procedimi penal nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Lushnje, për veprën penale “Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë”, parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal. Neni 178 i Kodit Penal nuk përfshihet në veprat penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar.

69. Bazuar në pikën 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, “krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni” përfshijnë veprat penale që sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale janë në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda, ose të çdo gjykate tjetër që mund ta zëvendësojë atë në ushtrimin e këtyre kompetencave. Neni 178 i Kodit Penal nuk përfshihet në veprat penale të parashikuara nga neni 75/a i këtij Kodi. Trupi gjyqësor i Kolegjit, bazuar në zbatimin e normave ligjore si më sipër, në përputhje me rrethanat dhe faktet e çështjes konkrete, arrin në përfundimin se shtetasi Sh. K. nuk përmbush kushtet për t’u cilësuar si person i përfshirë në krimin e organizuar.

Trupi gjyqësor i Kolegjit konstaton se, bazuar në raportin e DSIK-së dhe informacionin e Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e një kontakti të papërshtatshëm, bazuar në pikën 6 të nenit 3 të ligjit 84/2016, pasi ai ka pasur një takim të papërshtatshëm që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës, në rrethanat e parashikuara në nenin 38, pika 4, shkronjat “a” dhe “c” dhe se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me ushtrimin e detyrës, ka dhënë urdhra arbitrare dhe ka nënshkruar një vendim pushimi të procedimit penal, të pabazuar në ligj e prova, me qëllim favorizimin e personit nën hetim Sh. K.. Për sa u përket familjarëve të shtetasit SH. K., të cilët sipas informacioneve të përcjella nga organet ligjzbatuese, kanë qenë të dyshuar për dhënie mite ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjyqësor i Kolegjit konstaton se në aktet e administruara në fashikullin gjyqësor nuk rezultojnë të dhëna nëse këta persona kanë qenë të dënuar ose të proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar, apo për vepra penale që sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale janë në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda.

70. Trupi gjyqësor i Kolegjit vlerëson se bazuar në informacionin nr. {***} prot., datë 04.06.2018, i përcjellë në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe në shqyrtimin e dosjes penale të procedimit penal nr. {***}/2005 në ngarkim të shtetasit Sh. K., rezulton se vendimi i datës 17.03.2005 për zëvendësimin e prokurorit R.H., i nënshkruar nga Prokurori i Rrethit Adriatik Cama, vetëm cilëson se ekzistojnë arsye të parashikuara në nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale që prokurori duhet zëvendësuar, por nuk arsyeton se cilat janë këto arsye. Gjithashtu, vendimi datë 02.06.2005 i pushimit të procedimit penal ndaj shtetasit Sh. K., i marrë nga prokurori i çështjes G.J.T. dhe i nënshkruar edhe nga drejtuesi i Prokurorisë së Shkallës së Parë, Lushnje Adriatik Cama, ka qenë i pabazuar në ligj e prova dhe, me të drejtë, është shfuqizuar me vendimin datë 05.10.2005 të Drejtorit të Drejtorisë së Personelit dhe Inspektimit pranë Zyrës së Prokurorit të

Përgjithshëm, prokurori K. B.. Të gjitha këto fakte janë analizuar nga trupi gjykues i Kolegjit, duke arritur në përfundimin se ato nuk kualifikohen në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama nuk u provua të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, por ato mund të vlerësoheshin nga Komisioni brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të këtij ligji.

Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i bazuar.

71. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi çështjen në tërësi, pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim, si dhe provat e administruara në këtë çështje, për kriterin e vlerësimit të pasurisë arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama:
- a) ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me vlerën e blerjes së apartamentit 76,73 m², në rrugën “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2003, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016;
 - b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë ambient ish-parkim/garazh, të përshtatur dyqan, me sipërfaqe 45,56 m², në rrugën “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016;
 - c) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë autoveturë tip “Volkswagen Passat”, vit prodhimi {***}, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016;
 - ç) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e depozitës 4.000 euro, nga bashkëshortja e tij në bankën “Intesa San Paolo”, në vitin 2008, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016;
 - d) ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në deklaratat e pasurisë në vite, pasi nuk ka deklaruar gjendjet e llogarive bankare në fund të viteve përkatëse; nuk ka deklaruar të ardhura të kredituara nga të tretë në llogaritë e tij dhe të bashkëshortes së tij ndër vite, si dhe burimin e krijimit të tyre, si dhe nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendjen e likuiditeteve në bankën “Credins” në vlerën prej 1039 eurosh në deklaratën e pasurisë së vitit 2009, sipas pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
72. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të pikave 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

73. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi çështjen në tërësi, pretendimet e subjektit të parashtruara në ankim, si dhe provat e administruara në këtë çështje, për kriterin e kontrollit të figurës, arrin në përfundimin:
- a) Faktet e analizuar nga Komisioni nuk kualifikohen në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, por ato mund të vlerësoheshin nga Komisioni, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të këtij ligji.
74. Për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk u provua të jetë në kushtet e nenit 61, pika 3 e nenit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, e gjen të drejtë pretendimin e tij se nuk ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.
75. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit dhe bazuar në konkluzionet si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.
76. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit Adriatik Cama gjendet në kushtet e nenit D, pikat 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues i Kolegjit

VENDOSI:

1. Lënie në fuqi të vendimit nr. 35, datë 12.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Adriatik Cama.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
3. U shpall sot, në Tiranë, më datë 18.02.2019.

ANËTARE

ANËTAR

ANËTAR

Ina RAMA

nënshkrimi

Luan DACI

nënshkrimi

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

KRYESUES

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

Ardian HAJDARI

nënshkrimi